



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

AUDITIMIN E PËRPUTSHMËRISË TË USHTRUAR NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT VLORE DHE NË ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË”

TIRANË, JANAR 2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	2-8
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
1.	Objekti i auditimit	8-10
2.	Qëllimi i auditimit	
3.	Identifikimi i çështjes	
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5.	Përgjegjësitë e audituesve	
6.	Kriteret e vlerësimit	
7.	Standardet e auditimit	
8.	Metodat e auditimit	
9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11-56
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	
III.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm	11-15
III.2	Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të shtetit për vitin 2018-2019. Zbatimi i kriterëve në çeljen e detajimit të planit fillestar, zbatimin e buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar dhe problematika e konstatuar në drejtëm të realizimit të fondeve buxhetore. Raportimet mbi rezultatet e monitorimit.	15-17
III.3	Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave që realizon institucioni. Burimet e krijimit të ardhurave. Mbledhja e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore. Auditim mbi përdorimin e të ardhurave nga institucioni.	17-20
III.4	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Respektimi i kufijve të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e përdorimin e fondit veçantë, dhënien e shpërblimeve për ndihma fatkeqësi, etj.	20-22
III.5	Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë, auditim me zgjedhje dhe veprimet në valutë për të gjithë periudhën e kontrollit. Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën, auditim me zgjedhje. Inventarizimi i pronës shtetërore dhe regjistrimi në zyrat e pasurisë.	22-27
III.6,	Auditim mbi zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe dhënia e mendimit për pajisjen e subjektit me leje mjedisore. Mbi zbatimin e procedurave për pajisjen e subjektit me autorizim dhe pëlqim mjedisor.	27-40
III.7,	Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të vetëmonitorimit dhe monitorimit të mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi. Mbi auditimin e dosjeve mjedisore.	
III.8	Mbi auditimin e ushtruar nga DRM, në subjektet që me aktivitetin e tyre kanë ndikim të lartë e të mesëm në mjedis.	40-40
III.9	Auditim mbi zbatimin e marrëveshjeve me organet e tjera të kontrollit, për kryerjen e inspektimit e kontrolleve të përbashkëta.	
III.10	Auditim mbi aplikimin e sanksioneve të vendosura regjistrimi i tyre dhe ndjekja e arkëtimit të tyre.	
III.11	Kryerja e inspektimeve për zbatimin dhe kontrollin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve nga DR ISHMPUT Vlorë a. Mbi planifikimin vjetor dhe të veprimtarisë së inspektimit si Degë Rajonale e Qarkut Vlorë dhe zbatimi i saj. b. Analiza periodike e punës inspektuese, problematikave të dala dhe zgjidhjet e dhëna në Degën dhe bashkërendimi i punës me ISHMP në nivel qendror. c. Mbi procedurat e ndjekura për dhënien e autorizimeve për inspektim, afati, shpërndarja e burimeve njerëzore, mënyra e raportimit të kryerjes së inspektimit. d. Dokumentacioni i hartuar në procedurat e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve, listimi i tyre dhe vlerësimi i formës dhe përmbajtjeve të akteve të inspektimit, përputhshmëria ligjore e tyre për shkeljet e konstatuara dhe masa administrative e vendosur, shkalla e shkeljes ligjore. e. Regjistri i inspektimeve dhe analiza e rezultateve, si dhe zbatimi i ligjit “Për kundërvajtjet administrative, mënyra e ekzekutimit të gjobave e masave të tjera ndëshkuese e parandaluese. f. Inspektimet e kryera në Degën Doganore Vlorë për parandalimin e dëmtimit të cilësisë së mjedisit apo të përbërësve të tij të veçantë. i. Auditim mbi procedurat e tjera që kryen ky institucion në përmbushje të funksionit të tij	40-56
III.12	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	56-56
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	56-66
V.	ANEKSE	66-75



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim në ish-Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Vlorë dhe ish-Degën Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve Ujërave dhe Turizmit Vlorë, aktualisht Drejtoria Rajonale Mjedisore Fier, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar të institucionit, vlerësimin procedurës së miratimit të lejeve mjedisore të tipit C, kryerjen e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, planifikimit dhe kryerjes së inspektimit në mjedis, pyje, ujëra dhe turizëm, penalitetet e vendosura nga inspektorët, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, bashkëpunimet e ISHMPUT me institucione të tjera për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta si dhe vlerësimin e aktivitetit të komisionit të shqyrtimit të ankesave (organi epror) të bëra nga subjektet private ose publike. Gjatë periudhës së auditimit nga data 18.06.2020-31.07.2020, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2019 “Mbi nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe vlerësimin e aktivitetit të institucionit për procedurat e miratimit të lejeve mjedisore, inspektimit, sekuestrimit, vendosjes së penaliteteve, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar”.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit janë mbajtur gjithsej 3 akt-verifikime dhe 11 akt-konstatime sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e DRM Vlorë dhe DRISHMPUT Vlorë. Mbi aktet e mbajtura në periudhën e auditimit dhe Projekt Raportin janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të auditimit rezultoi:

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë, rezulton se nga 362 subjekte të inspektuara përgjatë vitit 2019, kanë rezultuar pa leje mjedisore 192 subjekte, për të cilat nuk është marrë masë administrative gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 57,600 mijë lekë (192 subjekte * 300,000 lekë që është vlera minimale e gjobës që duhej të vendosej).

-DRISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, duke mos vendosur asnjë penalitet ndaj subjekteve të cilat kanë hedhur mbetjet e tyre në 337 ambiente dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt negativ financiar në vlerën 10,110 mijë lekë, vlera minimale në rast se do të ishin vendosur gjoba ndaj këtyre subjekteve.

-Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, pasi nga 319 inspektime të kryera për periudhën 2018-2019, janë marrë gjithsej 66 vendime dënime administrative “Gjobë” me vlerë 19,056 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 633 mijë lekë (12 gjoba të paguara), ose 3.3% e gjobave të vendosura, duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, në vlerën 18,423 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të tyre.

-Drejtoria Rajonale e ISHMPUT, Vlorë, ka zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna më parë nga KLSH, sipas shkresës nr. 960/7prot., datë 17.12.2016, konkretisht:

- 2 masa për shpërbllim dëmi për vlerën 2,500,000 lekë, nuk janë zbatuar, përkatësisht:

* vlera 500,000 lekë, nuk është kontabilizuar dhe arkëtuar nga K. L., pavarësisht se subjekti pretendon se është falur nga Komisioni Ankimor, sipas vendimit nr.1, datë 23.07.2014, vendim të cilin KLSH e ka cilësuar të pa mbështetur ligjërisht.

* vlera 2,000,000 lekë, nuk është kontabilizuar dhe arkëtuar nga subjekti “G. B”.

- 1 masë të ardhura të munguara, rezulton e zbatuar pjesërisht.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

- nga 56 masa organizative të rekomanduara, nuk janë zbatuar 3 rekomandime, janë zbatuar 10 rekomandime, zbatuar pjesërisht 11 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 32 rekomandime.

-Nga auditimi i 50 praktikave të miratimit të lejes mjedisore të tipit C, për 12 subjekte, “E. A”, “M. N”, “O” Shpk në dy praktika të miratimit të lejes mjedisore, “N. A. T”, “A. Ç”, “A. H”, “A. S”, “Y. B”, “M shpk”, “C. shpk”, “J. Ç”, janë konstatuar veprime dhe mosveprime (miratim i lejes mjedisore në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, në mungesë të pagesës së tarifës së aplikimit, në mungesë të zhvillimit të procedurës së VNM-së, raporti i gjenerimit të zhurmave).

-Në 12 raste, janë konstatuar veprime/mosveprime (si mos pasqyrimi i llojit të shkeljes dhe sasisë së drurit të transportuar në mënyrë të paligjshme, në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, në vendimin përfundimtar të inspektimit, nuk jepet masa për sekuestrimin e lëndës drusore të transportuar në mënyrë të paligjshme, mosrespektim të kushteve të lejes mjedisore);

-Në 11 raste, nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet nuk janë sjellë raportet e vetë-monitorimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara në kushtet e lejes mjedisore të tipit C, për të cilat nga DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë përgjatë inspektimeve të kryera, pranë këtyre subjekteve;

-Në 10 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit në pyje, konstatohet se, listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit, nuk është plotësuar saktë sipas çdo rubrike, si dhe në 4 raste prej tyre këto dokumente nuk administrohen në dosjen përkatëse të inspektimit;

-Në 4 raste për subjektet: “A. P.”, “A. B.”, “S. G.”, “A. H.”; nga inspektorët nuk është llogaritur dëmi i shkaktuar në ekonominë pyjore, si pasojë e veprimeve të paligjshme të subjekteve private (prerje të druve pyjor, për të cilat nuk është specifikuar lloji i tyre nga inspektorët, ç’ka e ka bërë të pamundur llogaritjen e tyre nga grupi i auditimit);

-Në një 1 rast inspektimi, në subjektin “C”, SHPK, listë-verifikimi i inspektimit nuk është plotësuar saktë dhe nuk pasqyron realitetin, pasi ky subjekt në kohën kur është kryer inspektimi, nuk ka disponuar asnjë leje mjedisore, ndryshe nga çfarë është pasqyruar nga inspektorët në listë-verifikimin përkatës, konfirmuar kjo edhe nga verifikimi i grupit të auditimit, për lejet dhe licencat e këtij subjekti të publikuara në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (praktikat e inspektimit), është konstatuar se DRISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, duke mos vendosur asnjë penalitet (gjobë) ndaj subjekteve, të cilat kanë hedhur mbetjet e tyre në 337 ambiente të pa miratuara për hedhjen e mbetjeve.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë, rezulton se nga 362 subjekte të inspektuara përgjatë vitit 2019, kanë rezultuar pa leje mjedisore 192 subjekte, për të cilat nuk është marrë masë administrative gjobë, duke krijuar *të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 57,600 mijë lekë* (192 subjekte * 300,000 lekë që është vlera minimale e gjobës që duhej të vendosej).

Nga 481 subjekte të pajisur me leje mjedisore në vitet 2018 dhe 2019 nuk janë paguar tarifat vjetore të lejes mjedisore, në shumën **1,278 mijë lekë** konkretisht:

- Nga 116 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2017, por që aktiviteti i tyre i shtrin efektet edhe në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 86 subjekte, *duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 172,000 lekë*. Gjithashtu, konstatohet se edhe në vitin 2019, vetëm 14 prej tyre kanë paguar tarifën, ndërsa 72 subjektet e tjera nuk kanë paguar, në vlerën 144,000 lekë, pra në total për dy vitet *janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 316,000 lekë*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

- Nga 140 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 118 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhet e shtetit* në vlerën 236,000 lekë.
- Nga 218 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2019, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 205 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhet e shtetit* në vlerën 410,000 lekë.
- Në Bashkinë Vlorë dhe Himarë, sipas listës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për subjektet aktive në treg, vendosur në dispozicion nga DRM Vlorë, gjatë vitit 2017-2018, janë hapur për herë të parë dhe janë aktive deri më 31.12.2018, gjithsej 222 subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me leje mjedisore, kryesisht të tipit B dhe C, nga të cilat:
 - 150 subjekte nuk janë pajisur me leje të tipit C, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 1,500 mijë lekë (150 * 10 mijë lekë/tarifa e pajisjes me lejen C);
 - 72 subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me leje të tipit B, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 2,160 mijë lekë (72 * 30 mijë lekë/tarifa e pajisjes me lejen C) dhe që kanë ndikim të lartë në mjedis, për të cilat nga DRM Vlorë në bashkëpunim me DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë, për pajisjen e tyre me leje mjedisore.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJE TJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
1.	Në Bashkinë Vlorë dhe Himarë, sipas listës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për subjektet aktive në treg, vendosur në dispozicion nga DRM Vlorë, gjatë vitit 2017-2018, janë hapur për herë të parë dhe janë aktive deri më 31.12.2018, gjithsej 222 subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me leje mjedisore, kryesisht të tipit B dhe C, nga të cilat: - 150 subjekte nuk janë pajisur me leje të tipit C, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 1,500 mijë lekë (150 * 10 mijë lekë/tarifa e pajisjes me lejen C); - 72 subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me leje të tipit B, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 2,160 mijë lekë (72 * 30 mijë lekë/tarifa e pajisjes me lejen C) dhe që kanë ndikim të lartë në mjedis, për të cilat nga DRM Vlorë në bashkëpunim me DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë, për pajisjen e tyre me leje mjedisore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën c, pika 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar	Faqe 22-33	E lartë	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme për eliminimin e praktikave të tilla në të ardhmen dhe me ndikim negativ financiar në buxhetin e shtetit, duke garantuar që asnjë subjekt të mos ushtrojë aktivitet pa lejen mjedisore përkatëse. Gjithashtu, nga DRM Fier të marren masa për vlerësimin e situatës së krijuar dhe nxjerrjen e përgjegjësive rast pas rasti ndaj personave që kanë lejuar këtë situatë, si dhe ngarkimin e tyre me përgjegjësi ligjore.
2.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë, rezulton se nga 362 subjekte të inspektuara përgjatë vitit 2019, kanë rezultuar pa leje mjedisore 192 subjekte, për të cilat nuk është marrë masë administrative gjorbë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 57,600 mijë lekë (192 subjekte * 300,000 lekë që është vlera minimale e gjorbës që duhej të vendosej), duke vepruar në kundërshtim me nenin 1, 3, 5, 52 dhe 69 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i	Faqe 44-61	E lartë	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, për rishqyrtimin e inspektimeve të kryera në 192 subjektet e mësipërme, të nxirren përgjegjësitë dhe personat përgjegjës deri në ngarkimin e tyre me përgjegjësi ligjore, për mos aplikimin e masave parandaluese dhe penalizuese në vlerën 57,600 mijë lekë, ndaj subjekteve të konstatuara pa leje mjedisore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

GJE TJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
	ndryshuar			
3.	DRISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, duke mos vendosur asnjë penalitet ndaj subjekteve të cilat kanë hedhur mbetjet e tyre në 337 ambiente dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt negativ financiar në vlerën 10,110 mijë lekë, vlera minimale në rast se do të ishin vendosur gjoba ndaj këtyre subjekteve, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të bëra në nenet 1, 3, 5, 52, 69 të Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar; në nenin 21, pika 19 dhe nenin 30 e 37 të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet e shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe nenin 4 pika 33 të nenit 73, pikën 1 të nenit 97 të Ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar	Faqe 34-45	E lartë	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të analizojë situatën, të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, duke vendosur penalitete, ndaj subjekteve që hedhin mbetje në vende të pa përcaktuara nga bashkitë e Qarkut Vlorë, Qarkut Fier dhe Qarkut Gjirokastrë, me qëllim eliminimin e praktikave që sjellin efekte negative financiare në buxhetin e shtetit.
4.	Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, pasi nga 319 inspektime të kryera për periudhën 2018-2019, janë marrë gjithsej 66 vendime dënime administrative “Gjobë” me vlerë 19,056 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 633 mijë lekë (12 gjoba të paguara), ose 3.3% e gjobave të vendosura, duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, në vlerën 18,423 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të tyre. Konkretisht: - Për vitin 2018 janë marrë 35 vendime administrative, në vlerën 9,851 mijë lekë, nga këto, 19 mjedisi dhe 16 policia pyjore, nga të cilat janë arkëtuar 7 subjekte, për shumën 603 mijë lekë, ose 6 % ndaj totalit vlerës gjobave. - Për vitin 2019 janë marrë 31 vendime administrative, për shumën 9,205 mijë lekë, nga këto 12 mjedisi dhe 19 sektori i policisë pyjore, nga të cilat janë arkëtuar nga 5 subjekte në vlerën 30 mijë lekë, ose 0,3% e totalit të gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, në pikën 1 të nenit 40/1, të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për pyjet e shërbimin pyjor”	Faqe 34-45	E lartë	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masa që të hartohet një program pune, me afate të përcaktuara e persona përgjegjës për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën 18,423 mijë lekë nga vendosja e masave administrative (gjobë), si dhe të marrë masa për kontabilizimin e tyre si të ardhura dytësore, në bilancin financiar, tek pasqyra e të ardhurave, formati nr. 2, llogaria 7115 “Gjoba, kamatëvonesa etj.” kap. III “Të ardhura jo tatimore”.
5.	Nga 481 subjekte të pajisur me leje mjedisore në vitet 2018 dhe 2019 nuk janë paguar tarifat e përcaktuara në shumën 1,278 mijë lekë konkretisht: - Nga 116 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2017, por që aktiviteti i tyre i shtrin efektet edhe në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 86 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 172,000 lekë. Gjithashtu, konstatohet se edhe në vitin 2019, vetëm 14 prej tyre kanë paguar tarifën, ndërsa 72 subjektet e tjera nuk kanë paguar, në vlerën 144,000 lekë, pra në total për dy vitet janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 316,000 lekë. - Nga 140 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2018, konstatohet se	Faqe 15-17	E lartë	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit, për vlerën 1,278 mijë lekë, si pasojë e mos pagesës së tarifës vjetore të lejes mjedisore të tipit C, (2 mijë lekë/leje mjedisore), sipas tabelave nr. 2-4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

GJE TJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
	nuk kanë paguar tarifën vjetore 118 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhet e shtetit në vlerën 236,000 lekë. - Nga 218 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2019, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 205 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhet e shtetit në vlerën 410,000 lekë. Në të gjitha rastet nga titullari i DRM Vlorë, në rolin e nëpunësit autorizues, nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 5 të VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”			

I.KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

Opinion i kundërt¹

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së DRISHMPUT Vlorë dhe DRM Vlorë për periudhën 01.01.2018-31.12.2019, nëse kjo veprimtari është kryer duke respektuar dhe zbatuar, ligjet, rregulloret në fuqi, marrëveshjet, duke përfshirë këtu shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, miratimin e lejeve mjedisore, kryerjen e inspektimeve, zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen e penalteteve, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të DRISHMPUT-së dhe DRM-së, ku rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), si pasojë e mospërmbushjes së detyrave funksionale të institucioneve të auditimit.

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DR ISHMPUT Qarku Vlorë dhe DRM Vlorë rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave mbështesin dhënien e një **opinionit të kundërt**.²*

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentua se aktiviteti i kryer nga ish-DRISHMPUT dhe ish-DRM Vlorë për zbatimin dhe dhënien e akt-miratimeve për lejet mjedisore, kryerjen e inspektimeve në fushën e mjedisit, pyjeve, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2019, nuk ka qenë në përputhje me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, me dispozitat ligjore për dhëniet e lejeve mjedisore, kryerjen e inspektimeve, duke mos përmbushur detyrat funksionale të institucionit, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

¹ Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë** të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020, grupi II pika 7.3.3, Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjes janë materiale dhe të përhapura.

² Nen 4, pika 2, shkronja b, paragrafi i tretë “Opinion i kundërt, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura”, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave, me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DR ISHMPUT Qarku Vlorë dhe DRM Vlorë:

Drejtimi i DR ISHMPUT Qarku Vlorë dhe DRM Vlorë, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ish-DRISHMPUT Qarku Vlorë dhe ish-DRM Vlorë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikuar me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruam ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kundërt.

II. HYRJA

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vazhdim KLSH), në përputhje me kompetencat e parashikuara në zbatim të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr.560/1 prot., datë 18.06.2020, auditoi ish-Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, Vlorë (DRM Vlorë) si dhe ish-Degën Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Vlorë (DRISHMPUT Vlorë), aktualisht DRM Fier për periudhën raportuese (01.01.2018 deri më datë 31.12.2019), duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar të institucionit, vlerësimin procedurës miratimit të lejeve mjedisore, vlerësimin të ndikimit në mjedis, planifikimit dhe kryerjes së inspektimit në mjedis, pyje, ujëra dhe turizëm, penalitetet e vendosura nga inspektorët, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, bashkëpunimet e DRISHMPUT Vlorë me institucione të tjera për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta si dhe vlerësimin e aktivitetit të komisionit të shqyrtimit të ankesave (organi epror) të bëra nga subjektet private ose publike, në zbatim të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, siguria e nivelit të menaxhimit dhe transparenca me publikun, etj; Ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar; Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, etj;

DRM Vlorë ka filluar funksionimin me VKM nr.47, date 29.01.2014 “Per Percaktimin e Rregullave per Organizimin dhe Funksionimin e Agjencise Kombetare te Mjedisit e te Agjencive Rajonale te Mjedisit”, si dhe ISHMPUT ka filluar funksionimin me VKM nr.103, datë 14.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë”, e ndryshuar, të cilat varen nga Ministria e Mjedisit dhe e ushtrojnë aktivitetin në juridiksionin e vet në Qarkun e Vlorës.

Auditimi sipas çështjeve të shqyrtuara është kryer nga grupi i Auditimit i përbërë:

1. B. B, përgjegjës grupi
2. H. Metko, auditues,
3. K. K, auditues

II.1. Objektivi i auditimit.

Kryerja e auditimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë duke bërë vlerësimin ekonomiko-financiar të aktivitetit të institucionit, si dhe vlerësimin e aktivitetit lidhur me përmbushjen e funksioneve në zbatim të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”; ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar; ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe akteve nënligjore dala për zbatimin e tyre, me synim mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, ujërave, turizmit, rritjen e performancës në punë, mirëadministrimin e aseteve dhe fondeve publike si dhe rritjes së transparencës së institucionit.

II.2. Qëllimi i auditimit.

Dhënia e opinionit dhe lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në të ardhmen.

II.3. Identifikimi i çështjes.

ISH-DRM Vlorë dhe ISH-DRISHMPUT Vlorë, aktualisht DRM Fier, duhet të ketë organizimin e duhur, të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesit, duke patur në fokus mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit, si dhe shpenzimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

II.4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Niveli drejtues i institucionit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm të nevojshëm për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Gjithashtu këto dy institucione janë autoritetet kompetente të ngarkuar me ligj, për të kryer funksione rregullatore për dhënien e lejeve mjedisore të tipit C, inspektimin dhe aplikimin e sanksioneve që përcaktohen në kuadrin rregullator, ndaj subjekteve publike/private, të cilat kanë shkelur ligjin.

II.5.Përgjegjësitë e audituesve

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II.6.Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nën ligjore për zbatimin e tij;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore për zbatimin e tij;
- Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore për zbatimin e tij;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr.103, datë 14.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë”, e ndryshuar;
- VKM nr.47, date 29.01.2014 “Per Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencise Kombetare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, e ndryshuar.

II.7.Standardet e auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara.

II.8. Metodat e auditimit

1. Kërkimi zyrtar me shkrim i dokumentacionit;
2. Ekzaminimi dosjeve të prokurimit për të përcaktuar se si janë llogaritur fondet e projektit;
3. Ekzaminimi i dosjeve të inspektimit dhe i praktikave të miratimit të lejeve mjedisore;
4. Verifikimi i transaksioneve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

III.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme.

I. Mbi auditimin e zbatimit nga DRM Vlorë, të rekomandimeve të lëna më parë.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Vlorë në vijim (DRM) nuk është audituar më parë nga KLSH. DRM Vlorë është audituar më parë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për periudhën 01.01.2017- qershor 2019, sipas raportit final të auditit brendshëm nr. 24 datë 24.09.2019.

Auditi i brendshëm i Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit në përfundim ka lënë 8 rekomandime, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, konkretisht:

Rekomandimi 1. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë të hartojë urdhrin , për krijimin e ekipeve të menaxhimit programeve (EMP), në përputhje me UMF nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Zbatimi. **Detyrë e realizuar**, sipas urdhrin të drejtorit DRM Vlorë nr. 742 datë 18.10.2019.

Rekomandimi 2. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë, të zbatojë nenin 10 “Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit riskut” shtojca 7, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për emërimin e koordinatorit riskut dhe hartimin e regjistrin të riskut.

Zbatimi. **Detyrë e realizuar**, sipas programit të DRM Vlorë.

Rekomandimi 3. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë, të hartojë shkresën për vjeljen e tarifës vjetore mjedisit, për lejet e tipit A,B,C për subjektet, sipas VKM nr. 417 datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave lejeve të Mjedisit” dhe të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme vjeljen dhe evidentimin e tarifave sipas dispozitave ligjore dhe rregullave të përcaktuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Zbatimi. **Detyrë e pa realizuar.**

Rekomandimi 4. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë, të hartojë planin vjetor në fillim të çdo viti, për vjeljen e tarifave vjetore mjedisit për lejet A, B, C, sipas VKM nr. 419 datë 24.06.2014, të pasqyruara në regjistrin e lejeve në sektorin të DRM Vlorë.

Zbatimi. **Detyrë e pa realizuar.**

Rekomandimi 5. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë, të bashkërendojë në mënyrë të vazhdueshme punën me ISHMPUT dhe administratën tatimore Vlorë, me qëllim evidentimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje mjedisore.

Zbatimi. **Detyrë e pa realizuar.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Rekomandimi 6. Për subjektet e pajisura me leje mjedisore, që nuk kanë dorëzuar raportet e vet monitorimit, DRM Vlorë duhet të fillojë zbatimin e pikës “b” të nenit 27 “Revokimi i lejes së mjedisit të tipit A, B, C të ligjit 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar ku thuhet: *Ministri për lejet e mjedisit të tipit A, B, C dhe ARM përkatëse, për lejet e mjedisit të tipit C mund të pezullojë ose të revokojë lejen e mjedisit kur b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit.*

Zbatimi. **Detyrë e pa realizuar.**

Rekomandimi 7. Të vazhdojë komunikimi dhe të rritet bashkëpunimi me bashkitë, për të bërë mendimin e tyre pjesë të dosjes për miratimin/ refuzimin e aplikimeve të subjekteve për pajisje me leje mjedisi.

Zbatimi. **Detyrë e pa realizuar.**

Rekomandimi 8. Me qëllim që Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë të realizojë në kushte normale pune detyrat me karakter administrativ dhe teknik, AKM duhet të mundësojë sigurimin e kushteve optimale të ambienteve të punës dhe mjeteve të transportit të nevojshme për realizimin me efektivitet të veprimtarisë saj.

Zbatimi. **Detyrë e pa realizuar,** pasi varet nga AKM dhe MTM Tiranë.

Sa sipër, Zbatimi i detyrave ka qenë i pjesshëm, pasi nga 8 rekomandime janë zbatuar 2 dhe nuk janë zbatuar 6 detyra. Moszbatimi i disa rekomandimeve bie ndesh me urdhrin nr. 70, datë 18.4.2006 të Kryeministrit ‘Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit Shtetit dhe Auditit Brendshëm’ dhe me ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshime në ligjin nr. 8599, datë 01.01.2000, me nenin 10 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative “ dhe me nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës “, i ndryshuar, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe me udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, çka bën përgjegjës Xh. H. M. H. K. R. T. A. L. K. S. S, financierin Sh. K dhe drejtorin e DRM Vlorë z. K. L.

Auditimi i brendshëm i Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit

Për efekt mos dublimi, nga grupi i auditimit KLSH, u shfrytëzua raporti i auditit brendshëm i kryer për të njëjtën periudhë auditimi viti 2018 deri në 6-mujorin e parë 2019, ku rezultoi:

- Auditimi i kryer nga audituesit e brendshëm të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, sipas raportit final nr. 24 datë 24.09.2019 për periudhën 01.01. 2017- qershor 2019, **ka qenë i cekët dhe me mangësi, madje me disa shmangie të gjetjeve,** konkretisht:

* Auditimi i brendshëm ka lënë 8 rekomandime, nga të cilat 5 prej tyre janë kërkesa ligjore dhe subjekti e ka detyrë ti zbatojë ato dhe nuk mund të lihen detyra “zbato ligjin”.

* Auditimi i brendshëm nuk ka trajtuar 2 shkeljet tek pagesat për vjetërsi pune, *trajtuar nga ana jonë tek pika e pagave të punës.*

* Auditimi i brendshëm nuk ka trajtuar gjobat për vonesa në derdhjen e tatimit dhe sigurimeve shoqërore, për vlerën 45,304 lekë likuiduar nga DRM, në vend që të likuidohej nga personat fajtor dhe jo nga fondet e institucionit, siç e përcakton shkresa e DTS.

* Auditimi i brendshëm flet kompletim të dosjeve të personelit, në fakt ato kanë mangësi si certifikata, lista notash, librezat pune etj, *trajtuar tek pika e marrëdhënieve të punës.*

* Auditimi i brendshëm flet për ndikimin në mjedis të qendrave shëndetësore, pikat e karburantit dhe serviset e qarkut Vlorë, por nuk trajton se cilat janë këto subjekte që kryejnë aktivitet pa leje mjedisore dhe që kanë ndikim negativ mjedisor.

II. Mbi auditimin e zbatimit nga ISHMPUT Vlorë, të rekomandimeve të lëna më parë.

Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë është audituar më parë nga KLSH, ku në përfundim janë lënë për zbatim rekomandimet, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, konkretisht: 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

masë për përmirësim ligjor, 56 masa organizative, 1 masë ardhura munguara dhe 2 masa për shpërblim dëmi për vlerën 2,500,000 lekë, sipas shkresës KLSH nr. 960/7, datë 17.12.2016. Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë ka filluar zbatimin e detyra të lëna, duke hartuar plan veprimi nr. 65/1 datë 22.02.2017 ose rreth 2 muaj me vonesë, me grup pune të përbërë nga 7 veta, përkatësisht: Gj. M kryeinspektor, Q. Z financier, A. B. jurist, I. M, E. K, N. C dhe E. B. inspektorë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me shkronjën “j” të nenit 13 dhe pikën 2 të nenit 30, të Ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. **Zbatimi nga DR ISHMPUT Vlorë i rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH ka qenë i pjesshëm**, në mënyrë të përmbledhur, konkretisht:

-1 masë për përmirësim ligjor, rezulton se **është zbatuar**.

-56 masa organizative, rezulton **zbatim të pjesshëm**.

-2 masa për shpërblim dëmi për vlerën 2,500,000 lekë, rezulton se **nuk janë zbatuar**.

-1 masë të ardhura munguara, rezulton **zbatim të pjesshëm**,

Më analitikisht:

A. Masa për përmirësim ligjor.

Nga **1 masë për përmirësim ligjor** e rekomanduar, rezulton e **zbatuar 1 masë**, konkretisht:

1. Rekomandimi: DR ISHMPUT Vlorë dhe ISHMP Tiranë të marrin masa ti kërkojnë Ministrisë Mjedisit një udhëzim të ri dhe të shfuqizojnë udhëzimin nr.1 datë 04.07.2014, pasi nuk është funksional.

Zbatimi: Kjo **masë është zbatuar**. Kështu, ISHMPUT Vlorë i ka dërguar Ministrisë Mjedisit kërkesë, për ndryshimin ose shfuqizimin e udhëzimit saj nr. 1 datë 04.07.2014, i cili nuk është i qartë, çka ka sjellë keqadministrim (dokumentar) të lëndës drusore të sekuestruar, në vazhdim ka zbatuar udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i cili shpreh qartë mënyrën e administrimit mallrave e materiale nëpërmjet flet hyrjeve dhe flet daljeve dhe nuk paraqet nevojën për interpretim të tij nëpërmjet udhëzimit nr. 1 datë 04.07.2014.

B. Masa Organizative.

Nga **56 masa organizative** të rekomanduara sipas shkresës KLSH nr. 960/7, datë 17.12.2016, rezulton se nga DR ISHMPUT Vlorë janë **zbatuar pjesërisht**, konkretisht: **nuk janë zbatuar 3 rekomandime, janë zbatuar 10 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 11 rekomandime dhe janë në proces 32**, më hollësisht:

Nuk janë zbatuar 3 rekomandime, sa vijon:

Rekomandimi 24: DR ISHMPUT Vlorë, kryeinspektori, strukturat përkatëse, sektori i mjedisit, juristi dhe financa të marrin masa në bashkëpunim të vendosin sistemin e mekanizmit të kontrollit brendshëm (SMKB) të trajtojnë dokumentacionin e procedurës gjobave si letra me vlerë.....

Zbatimi: **Nuk është realizuar rekomandimi 24**, për SMKB dhe trajtimin e gjobave si letra me vlerë.

Rekomandimi 25: DR ISHMPUT Vlorë, juristi dhe financa të marrin masa, të evidentojë sipas procesit, të çelë në llogaritë përkatëse, të regjistrojë në kontabilitet sipas parimit të kontabilitetit dhe të rakordojë me Ministrinë Mjedisit për gjobat e likuiduara nga kreditorët përkatës dhe ti pasqyrojë në pasqyrat financiare vjetore pozicionin e llogarive.

Zbatimi: **Nuk është realizuar rekomandimi 25**, për kontabilizimin dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare të bilancit tek formati i të ardhurave.

Rekomandimi 45: DR ISHMPUT Vlorë, kryeinspektori, të marrë dhe të përcjellë zyrtarisht në DR ISHU Vlorë dosjet dhe praktikat e inspektimit të sektorit ujërave, shkresat, korrespondencat dhe dokumentacionin tjetër relevant, në këtë fushë të inspektimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Zbatimi: **Nuk është realizuar rekomandimi 45**, për inspektimin e zonave të ndotjes nga ujërat e zeza dhe aplikimit sanksioneve.

Janë zbatuar 10 rekomandime, sa vijon:

- Është realizuar rekomandimi 4, pasi është hartuar rregullorja e brendshme e re nr. 1, datë 24.07.2019,
- Është realizuar rekomandimi 10, që bën fjalë për shumën 7500 lekë dhe 12,000 lekë dieta të papaguara ndaj 6 punonjësve për periudhën 20.05.2016- 31.10.2016, e sistemuar.
- Është realizuar rekomandimi 11, që bën fjalë për pasqyrimin e treguesve financiar si realizim dhe planifikim....
- Është realizuar rekomandimi 12, bën fjalë për futjen e të dhënave në sistem elektronik....
- Është realizuar rekomandimi 28, që bën fjalë për kryerjen e inventarizimit dhe krijimin e komisioneve përkatëse,
- Është realizuar rekomandimi 50, 51, 52 53 dhe 55, për trajnimin e komisioneve prokurimeve publike me legjislacionin e prokurimit publik dhe aplikimin e sistemit elektronik të prokurimeve.

Janë zbatuar pjesërisht 11 rekomandime, sa vijon:

- Është realizuar pjesërisht rekomandimi 15, pasi nuk është kryer numerizimi flet për flet i dokumentacionit, ndërsa është kryer inventarizimi bruto i dosjeve dhe janë arshivuar.
- Është realizuar pjesërisht rekomandimi 22 dhe 23,
- Është realizuar pjesërisht rekomandimi 30,
- Është realizuar pjesërisht rekomandimi 35, 36, 37, 40, 41, 42 që bëjnë fjale për trajnimin e inspektorëve terrenit.
- Është realizuar pjesërisht rekomandimi 56, për kriteret e marrjes në punë të punonjësve të rinj nëpërmjet konkurrimit, sipas ligjit dhe emërimeve në punë.

Në vijimësi (proces) 32 rekomandime, sa vijon:

C/1. Të ardhura munguara.

Nga **1 masë ardhura munguara** e rekomanduar, rezulton **zbatim të pjesshëm**, konkretisht:

1. Rekomandimi: DR ISHMPUT Vlorë, kryeinspektori, strukturat përkatëse, sektori i mjedisit, juristi dhe financa të marrë masa konformë dispozitave ligjore për ri inspektimin e 39 subjekteve, *pasi nuk janë aplikuar gjoba mbi menaxhimin e ujërave ndotur në vlerën 19,500 mijë leke ose maksimumi 39,000 mijë lekë* dhe në inspektimin e radhës të mbajë procesverbalet për vendosjen e gjobave, regjistrimin e kontabilizimin dhe arkëtimin e gjobave subjekteve, duke ndjekur të gjitha hapat ligjore...

Zbatimi: Kjo masë “*ardhura munguara*” rezulton me **zbatim të pjesshëm**, pasi për 39 subjekte për vlerën 19,500 mijë leke ose maksimumi 39,000 mijë lekë, *për mos aplikim gjobash mbi menaxhimin e ujërave ndotur*, është në vazhdim vendosja e gjobave, problem i cili është verifikuar gjatë auditimit, por ka munguar kontabilizimi i këtyre vlerave e konsideruar ardhura munguara.

C/2. Masa për shpërblim dëmi.

Nga **2 masa për shpërblim dëmi për vlerën 2,500,000 lekë** të rekomanduara, rezulton se **2 masat nuk janë zbatuar**, konkretisht:

1. Rekomandimi: DR ISHMPUT Vlorë kryeinspektori, strukturat përkatëse, sektori i mjedisit, juristi dhe financa të marrë masa të kontabilizojë dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 500,000 lekë nga K. L, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, pasi vendimi nr. 1 datë 23.07.2014 i Komisionit Ankimor është i paligjshëm, sepse ka kaluar afatin ligjor të shqyrtimit dhe ankimit.

Zbatimi: **Masa për shpërblim dëmi për vlerën 500,000 lekë nga K. L. nuk është kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar**, pavarësisht se nga subjekti pretendohet që është falur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

nga Komisioni Ankimor sipas vendimit nr. 1 datë 23.07.2014, por KLSH e ka cilësuar të paligjshëm këtë vendim.

2. Rekomandimi: DR ISHMPUT Vlorë kryeinspektori, strukturat përkatëse, sektori i mjedisit, juristi dhe financa të marrë masa të kontabilizojë dhe të kërkojë arkëtimin e gjobës për vlerën 2,500,000 lekë ndaj subjektit “G. B”, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive.

Zbatimi: **Masa për shpërbllim dëmi për vlerën 2,000,000 lekë nga subjekti “G. B”, nuk është kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar,**

Sa sipër, Moszbatimi i disa rekomandimeve bie ndesh me urdhrin nr. 70, datë 18.4.2006 të Kryeministrit ‘Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit Shtetit dhe Auditit Brendshëm’ dhe me nenin 30 të Ligjit nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me nenin 10 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjen administrative” dhe me nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe me udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, çka ngarkojnë me përgjegjësi **Gj. M** kryeinspektor, **Q. Z.** financier, **A. B** jurist, **I. M,** **E. K, N. C dhe E. B** inspektorë.

Observacion: ISHMPUT Vlorë ka bërë observacion lidhur me 2 masat e zhdëmtimit.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, nuk e merre në konsideratë, pasi vërejtjet janë ezauruar më parë nga KLSH, sipas shkresës saj nr. 960/7, datë 17.12.2016.

III.2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të shtetit për vitin 2018-2019. Zbatimi i kriterëve në çeljen e detajimit e planit fillestar, zbatimin e buxhetit gjatë vitit, nivelet e realizimit të planit përfundimtar dhe problematika e konstatuar në drejtim të realizimit të fondeve buxhetore. Raportimet mbi rezultatet e monitorimit.

DRM Vlorë

Respektimi i procedurave për hartimin dhe miratimin e buxhetit si dhe zbatimi i tij për vitet 2018-2019. Projektbuxhetet për vitet 2018 dhe 2019 janë hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë sipas kërkesave të dërguara nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë dhe janë miratuar nga Ministria e Mjedisit brenda afateve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të nenit 22 të ligjit 99/2018 “Për buxhetin 2019” dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2. Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin dhe miratimin e buxhetit të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Vlorë për vitet 2018-2019, rezulton se programimi i shpenzimeve është bërë në nivel, titulli, kapitulli dhe artikulli e nën artikulli. Planifikimi dhe realizimi i fondeve për vitet 2018-2019, sipas tabelës mëposhtme:

Pasqyra nr. 1 Planifikimi dhe realizimi i fondeve 2018-2019 (000/lekë)

Nr	Emertimi i llogarise se shpenzimeve	Viti 2018		Viti 2019	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Llog.600 “paga e shperblime”	6,000	3,980	6,000	5,000
2	Llog.601 “Kontribute sig.Shoq”	1,000	690	1,000	821
3	Llog.602 “shpenzime operative”	250	224	250	247
	Totali	7,250	4,894	7,250	6,068

Burimi: DRM Vlorë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Për vitin 2018-2019 buxheti i DRM Vlorë nuk paraqet tejkalime, përkundrazi ka mos realizime. Sipas tabelës së mësipërme fondet e akorduara janë realizuar në masën 67 % për vitin 2018 dhe 83 % për vitin 2019, kjo e fundit është rritur krahasuar me vitin 2018, pasi ka ndikuar shtesa e zërit paga duke shtuar organikën me 3 veta (*nga 5 veta në 8 veta*). Fondet e çelura nga Dega e Thesarit, janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh dhe tejkalim limitesh. Gjatë zbatimit të buxheteve nuk janë bërë ndryshime të tij si në pakësim dhe në shtesa. Mbi bazën e të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Vlorë është rakorduar me degën e thesarit të rrethit për çdo muaj, mbështetur në udhëzimet respektive të Ministrisë Financave për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore. Realizimi i shpenzimeve operative është dokumentuar sipas nën artikujve të llogarisë nr. 602. Shpenzimet operative paraqesin zëra analitik të kufizuar (*postare, kancelari, dieta, detergjente, takse etj*) dhe me vlera në nivele të ulëta. Për çdo rast shpenzimet operative shoqërohen me dokumentacion të plotë. Nga krahasimi i buxheteve për 2 vitet rezulton që fondet në dispozicion të këtij institucioni janë planifikuar të njëjta ose në nivele të ulëta, duke e bërë të pamjaftueshëm realizimin e funksionit të këtij institucioni si dhe të objektivave dhe strategjive në ruajtjen e mjedisit, në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, VKM nr. 417 datë 26.06.2014.

DR ISHMPUT Vlorë.

Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Projektbuxhetet për vitet 2018 dhe 2019 janë hartuar nga DR ISHMPUT Vlorë sipas kërkesave të dërguara nga ISHMPUT Tiranë dhe janë miratuar nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit brenda afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të nenit 22 të ligjit 99/2018 “Për buxhetin 2019” dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2. Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin dhe miratimin e buxhetit të DR ISHMPUT Vlorë për vitet 2018-2019, rezulton se programimi i shpenzimeve është bërë në nivel, titulli, kapitulli dhe artikulli e nën artikulli. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas artikujve për vitin 2018 dhe 2019, të rakorduar me thesarin, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Pasqyra nr. 2 Planifikimi dhe realizimi i fondeve 2018-2019 (000/lekë)

Nr	Emertimi i llogarise se shpenzimeve	Viti 2018		Viti 2019	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Llog.600 “paga e shpërblime”	16,700	12,529	20,600	16,140
2	Llog.601 “Kontribute sig.Shoq”	2,700	2,055	3,300	2,687
3	Llog.602 “shpenzime operative”	1,100	997	1,000	886
4	Llog.606 “shpenzime tjera”		30	53	53
	Totali	20,500	15,611	24,953	19,766

Burimi: DRISHMPUT Vlorë

Për vitin 2018-2019 buxheti i DR ISHMPUT Vlorë nuk paraqet tejkalime, përkundrazi ka mos realizime. Sipas tabelës së mësipërme fondet e akorduara janë realizuar në masën 76 % për vitin 2018 dhe 79 % për vitin 2019. Fondet e çelura nga Dega e Thesarit, janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh dhe tejkalim limitesh. Gjatë zbatimit të buxheteve nuk janë bërë ndryshime të tij si në pakësim dhe në shtesa. Mbi bazën e të dhënave të DR ISHMPUT Vlorë është rakorduar me degën e thesarit të rrethit për çdo muaj, mbështetur në udhëzimet respektive të Ministrisë Financave për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore. Shpenzimet për paga në vitin 2019 janë planifikuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

dhe realizuar në një nivel më të lartë krahasuar me vitin 2018, pasi ka ndikuar shtesa prej 6 veta në organikën e institucionit në fund të vitit 2018 ose nga 21 veta viti 2018 ka arritur numri 27 veta viti 2019. Realizimi i shpenzimeve operative është dokumentuar sipas nën artikujve të llogarisë nr. 602. Shpenzimet operative paraqesin zëra analitik të kufizuar (*postare, kancelari, dieta, detergjente, takse etj*) dhe me vlera në nivele të ulëta. Për çdo rast shpenzimet operative shoqërohen me dokumentacion të plotë. Për vitin 2018 dhe 2019 shpenzimet operative janë në raport të drejtë 16 % me shpenzimet për paga dhe 13 % ndaj shpenzimeve në total, çka tregon efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet në përdorimin e tyre.

III.3. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave që realizon institucioni. Burimet e krijimit të të ardhurave. Mbledhja e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore. Auditim mbi përdorimin e të ardhurave nga institucioni.

DRM Vlorë

Agjencia Rajonale e Mjedisit Vlorë në vijim (DRM) është institucion rajonal publik në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për mbrojtjen e Mjedisit. Organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në vendimin nr. 47, datë 29.01.2014 “*Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit*”. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë, të ardhurat i krijon në bazë të ligjit nr. 10448 datë 27.04.2011 “*Për lejet mjedisore*” të Tipit C, të cilat derdhen në buxhetin e shtetit dhe nuk përdoren nga DRM. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarkut Vlorë, operon si institucion i pavarur me bilanc më vete, për vitin 2018-2019. Nga verifikimi i regjistrit të evidentimit të autorizimeve të lëshuara për pagesën e tarifës vjetore nga operatorët e instalimit të tipit C dhe rakordimit që është bërë midis Ministrisë të Mjedisit dhe Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Tiranë rezultojnë se:

1. Tarifa e shërbimit për shqyrtimin e kërkesës për nxjerrje të lejeve sipas kategorive rezultojnë:- *Leje mjedisi të tipit A, 50,000 lekë,- Leje mjedisi të tipit B, 30,000 lekë,- Leje mjedisi të tipit C, 10,000 lekë*

2. Operatorët paguajnë në llogari të ministrisë tarifën vjetore për:- *Instalimin e tipit A, në shumën 10,000 lekë.- Instalimin e tipit B, në shumën 5,000 lekë.- Instalimin e tipit C, paguajnë një tarifë vjetore prej 2,000 lekë, brenda 3-mujorit në llogarinë e DRM, sipas vendimit 417 datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave lejeve të Mjedisit”, pika 6.*

Me urdhër të Drejtorit të AKM të gjitha pagesat për tarifën vjetore do të kalojnë në llogari të Ministrisë e Mjedisit. Kjo drejtori nuk përfiton asnjë të ardhur nga pagesat për leje e mjedisit e tarifat vjetore. *Me shkresën nr. 294 datë 07.03.2015, Drejtori Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka përcjelle një shkresë me lëndë që të ardhurat të derdhë pranë llogarisë së Ministrisë së Mjedisit për tarifat e pajisjeve me leje të Tipit C.*

- **nuk ka hartuar shkresën për vjeljen e tarifave vjetore të mjedisit për lejet A, B, C, ndaj subjekteve,** sipas VKM nr. 417 datë 26.06.2014.

-**nuk ka hartuar planin vjetor në fillim të çdo viti, për parashikimin e të ardhurave ose vjeljen e tarifave vjetore mjedisit për lejet A, B, C,** sipas ligjit të buxhetit shtetit dhe VKM nr. 419 datë 24.06.2014, të pasqyruara në regjistrin e lejeve në sektorin e VNM.

- Nga 116 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2017, por që aktiviteti i tyre i shtrin efektet edhe në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 86 subjekte, *duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 172,000 lekë.* Gjithashtu, konstatohet se edhe në vitin 2019, vetëm 14 prej tyre kanë paguar tarifën, ndërsa 72 subjektet e tjera nuk kanë paguar, në vlerën 144,000 lekë, pra në total për dy vitet janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 316,000 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

- Nga 140 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 118 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhet e shtetit* në vlerën 236,000 lekë.
- Nga 218 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2019, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 205 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhet e shtetit* në vlerën 410,000 lekë. Në të gjitha rastet nga titullari i DRM Vlorë, në rolin e nëpunësit autorizues, nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 5 të VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”

Pra në total të ardhurat e munguara për periudhën 2017-2019 është në vlerën 962 mijë lekë, si pasojë e mos pagesës së tarifës vjetore të lejes mjedisore të tipit C.

Pasqyra nr.3 Të ardhurat për leje e tarifa mjedisore për vitin 2018-2019 të DRM Vlorë.

Viti	Leje Mjedisore nr. subjekteve	Arkëtime Vlera 000/lekë	nr. subjekteve pa kryer pagesat	Detyrim pa derdhur Vlera në 000/ lekë
2018	123	357	15	Nuk ka të dhëna
2019	230	1,074	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Totali	353	1,431	15	

Burimi: DRM Vlorë

Sipas pasqyrës DRM Vlorë për vitin 2018-2019 ka siguruar të ardhura nga 353 subjekte në vlerën 1,431 mijë lekë të ardhura në buxhetin e shtetit, leje dhe tarifa mjedisore, të përcaktuar në ligjin nr. 10448 datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, si dhe të vendimit nr. 417 datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit”, pika 6.

Përfundimisht, sa sipër dhe nga tabela shihet qartë se: **për vitin 2018-2019 struktura e DRM nuk ka funksionuar sa duhet**, pasi:

- * për vitin 2019 nuk ka një evidencë vjetore për numrin e aplikimeve për leje kategorisë C, sa nga këto janë pajisur me leje mjedisore dhe sa subjekte nuk janë pajisur ose janë refuzuar,
- * nuk ka të evidentuar debitorët e tarifave mjedisore dhe lejeve C,
- * nuk ka lista të subjekteve për mbylljen e aktivitetit dhe që nuk kanë paguar tarifën vjetore,
- * nuk disponohet shkresë për të informuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat e tarifave, të përcaktuara në ligjin dhe në vendimet e sipërcituara ndaj të cilave është kërkuar revokimi i lejes mjedisore QKL,
- * rakordimi ka qenë pjesor me drejtorinë rajonale të Tatimeve, NJQV, QKR, Bashkitë, për subjektet objekt i lejeve mjedisore.

Ngarkohen me përgjegjësi S. S ish specialiste e VNM, Xh. H ish specialist i lejeve mjedisore, M. H ish specialiste e lejeve mjedisore, K. R ish specialiste e protokollit, T. A ish specialiste e raporteve të vetmonitorimit, L. K ish specialiste e raporteve të vetmonitorimit, K. L ish Drejtor i DRM Vlorë.

DR ISHMPUT Vlorë

66 vendime dënime administrative “Gjobë” me vlerë 19,056 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 633 mijë lekë (12 gjoba të paguara), ose 3.3% e gjobave të vendosura, duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, në vlerën *18,423 mijë lekë*, si pasojë e mosarkëtimit të tyre. Konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

- Për vitin 2018 janë marrë 35 vendime administrative, në vlerën 9,851 mijë lekë, nga këto, 19 mjedisi dhe 16 policia pyjore, nga të cilat janë arkëtuar 7 subjekte, për shumën 603 mijë lekë, ose 6 % ndaj totalit vlerës gjobave.

- Për vitin 2019 janë marrë 31 vendime administrative, për shumën 9,205 mijë lekë, nga këto 12 mjedisi dhe 19 sektori i policisë pyjore, nga të cilat janë arkëtuar nga 5 subjekte në vlerën 30 mijë lekë, ose 0,3% e totalit të gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, në pikën 1 të nenit 40/1, të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për pyjet e shërbimin pyjor”

Nga auditimi i të ardhurave të DR ISHMPUT Vlorë për vitin 2018 dhe 2019, bazuar në evidencat dhe pasqyrat e bilanceve financiare përkatëse, rezultoi se:

- **për vitin 2018 janë vendosur 35 vendime dënimi administrativ për vlerën 9,851,000 leke**, nga këto 19 mjedisi dhe 16 Policia pyjore, ku janë **arkëtuar 7 prej tyre në vlerën 603,000 lekë ose 6 %** ndaj totalit vlerës gjobave (*likuiduar 6 vullnetarisht dhe 1 nga përmbarimi, ndërsa tjerat nuk janë ndjekur dhe ndalur, disa kane kaluar pranë komisionit ankimor dhe gjykatave, sipas pasqyrës në anekse*).

- **për vitin 2019 janë vendosur 31 vendime dënimi administrativ për vlerën 9,205,000 leke**, nga këto 12 mjedisi dhe 19 sektori i policisë pyjore, ku janë **arkëtuar 5 prej tyre në vlerën 30,000 lekë ose 0,3 %** ndaj totalit vlerës gjobave .

Pra për vitet 2018-2019 janë vendosur 66 dënime administrative “Gjobë” me vlerë 19,056 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 633 mijë lekë (12 gjoba të paguara), ose 3.3% e gjobave të vendosura, *duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, në vlerën 18,423 mijë lekë*, si pasojë e mosarkëtimit të tyre.

Sa më sipër,

* për vitin 2018 dhe 2019, **të ardhurat nga gjobat kanë qenë në nivele të ulëta dhe në rënie** nga viti në vit,

* për vitin 2018 dhe 2019, **arkëtimi i të ardhurave nga vjelja e gjobave paraqitet në nivel të ultë,**

* për vitin 2018 dhe 2019, **rritja e numrit të punonjësve për vitin 2019 është në raport të zhdrejtë me numrin dhe vlerën e gjobave të vendosura**, në vend që të ndodhte e kundërta, pasi i bie afërsisht 1 gjobë në vit për 1 punonjës, **çka tregon se funksionimi i institucionit nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe** me këtë numër inspektimesh nuk justifikohet puna e inspektorëve të mjedisit dhe pyjeve dhe as shtesa e organikës.

* **Të ardhurat nga vjelja e gjobave** për vitin 2018 në vlerën 9,851,000 leke dhe për vitin 2019 në vlerën 9,205,000 leke **nuk janë kontabilizuar në bilancin financiar**, pasqyra ardhurave formati nr. 2, llogaria 7115 “gjoba, kamatëvonesa etj” kap. III “të ardhura jo tatimore”, *por është mjaftuar me një evidencë vjetore bashkëngjite bilancit*.

* Për vitin 2018 dhe 2019 ka munguar parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve si dhe vlerësimi i riskut, dokumentimi dhe raportimi i veprimtarisë së inspektorëve, ka munguar kontrolli i ecurisë të procedurave ligjore dhe administrative, kërkesa këto të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, neni 7 e 16 “Misioni dhe funksionet e Inspektoratit qendror”, pika 2 germa “b” e “c”, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, të ligjit 9385 datë 23.04.2009 “Për pyjet e shërbimin pyjor”.

Për mos arkëtimin e gjobave të vendosura ngarkohen me përgjegjësi ish-kryeinspektori i degës ISHMPUT Vlorë A. B (20.07.2018 dhe vazhdim), E. B (prill- korrik 2018) dhe ish-Prgj., Sek., të Mjedisit I. M, A. B ish-Jurist si dhe ish-inspektorët, E. B, V. B, A. B, B. B p/sek/ujrave, M. H, O. Zh, A. Xh, E. B p/sek pyjeve, E. R, N. L, A. H, E. K, N. C, L. M, E. M, L. P, A. C, S. H dhe A. H.

Observacion: DR ISHMPUT Vlorë ka bërë Observacionin nr. 1100 datë 05.08.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë.

III.4. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Respektimi i kufijve të fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për ndihma për fatkeqësi, etj.

DRM Vlorë

DRM Vlorë është institucion publik në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me funksion mbrojtjen e mjedisit. Organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në vendimin nr. 47, datë 29.01.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”. Në bazë të ligjit të Shërbimit Civil, MFK dhe të dispozitave të ligjore për pagat e punonjësve, Titullari i institucionit në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Sektorin e Buxhet-Financës realizojnë hartimin dhe ndjekin zbatimin e Buxhetit, organizimin e procedurave të rekrutimit të stafit të ri, përgatitjen e procedurave të punësimit, për plotësimin e organikës dhe strukturave të miratuara. Sigurojnë zbatimin e dispozitave ligjore të pagave, kontabilizimin e transaksioneve financiare, si dhe menaxhimin e trajnimeve etj. Në mbështetje të Urdhrit të Kryeministrit nr. 55 datë 13.02.2014 mbi “Miratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, ndryshuar me Urdhrin nr. 150 datë 17.04.2014, ‘Për një ndryshim ne urdhrin nr. 55 date 13.02.2014’. Për vitin 2018-2019 numri i punonjësve në organikë të DRM-së Vlorë është 5 deri 8 punonjës për të cilën nga auditimi i dokumentacionit (liste pagesa, emërimet, etj) dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se është respektuar numri i punonjësve sipas organikës si dhe kategorive pagave përkatëse. Emërimet dhe lirimet nga puna në DRM Vlorë ka pasur për gjatë periudhës së audituar.

1. Për nëpunësit e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil. Kjo drejtori, ka qenë në vartësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ne përputhje me këto dispozita, Drejtori i Drejtorisë Rajonale emërohet nga Ministri.

Ne strukturën organike të miratuar të DRM Vlorë rolin e arkivistit e kryente një punonjës i pa trajnuar në këtë fushë. Arkiva dhe protokolli duhet të funksionojë sipas ligjit “Për Arkivin” dhe manualit rregullator “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në VKM nr. 187 date 8.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri aparatet e ministrive të linjës, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, DRM Vlorë ka zbatuar dhe hartuar strukturën dhe nivelin e pagave për secilin pozicion, sipas lidhjes nr. 1 “Për kategoritë dhe shtesën e pozicionit” si dhe lidhje nr. 2 “Për pagën e grupit sipas llojit diplomës”, sipas së cilës përcaktohet kategoria III-b me grupin 1 Drejtor dhe IV-b për specialistët.

Organika dhe struktura.

Organika dhe struktura e miratuar për **vitin 2018** përbëhet nga **5 punonjës**, konkretisht: 1 Drejtor jurist, 1 specialistë finance, 1 specialist monitorimi, 2 specialist (VNM).

Organika dhe struktura e miratuar për **vitin 2019** përbëhet nga **8 punonjës**, konkretisht: 1 Drejtor jurist, 1 specialistë finance, 1 specialist monitorimi, 5 specialist (VNM).

Pra për periudhën e audituar 2018-2019 nuk ka tejkallim të strukturës.

Planifikimi dhe realizimi i fondeve për paga, sigurime shoqërore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Planifikimi dhe realizimi i fondeve për paga, sigurime shoqërore për vitin 2018- 2019 i ndarë sipas viteve, paraqitet sa vijon:

Pasqyra nr. 4 Planifikimi dhe realizimi i fondeve për pagat

Nr	Emertimi i llogarise shpenzimeve	Viti 2018		%
		Plan	Fakt	
1	Llog.600"paga e shperblime"	6,000	3,980	66
2	Llog.601"Kontribute sig.Shoq"	1,000	690	69

Burimi:DRM Vlorë

Realizimi i fondit të pagave për vitin 2018 është në masën 66 % (pl=6000 dhe fakt=3980). Mosrealizimi në zërin "Paga" në shumën 2,020 mijë leke ka ardhur si rezultat i parashikimit të fondit të pagave me rezerva, duke mos iu referuar projekt buxhetit. Mosrealizimi në shumën 310 mijë lekë në zërin "Sigurime shoqërore" ose 69 % ka ardhur si rezultat i përlllogaritjes me jo me saktësi në planifikim i pagave, fond mbi të cilën janë përlllogaritjet e fondeve për sigurime shoqërore.

Pasqyra nr. 5 Planifikimi dhe realizimi i fondeve për pagat

Nr	Emertimi i llogarise se shpenzimeve	Viti 2019		%
		Plan	Fakt	
1	Llog.600"paga e shperblime"	6,000	5,000	83
2	Llog.601"Kontribute sig.Shoq"	1,000	821	82

Burimi:DRM Vlorë

Realizimi i fondit të pagave për vitin 2019 është realizuar në masën 83 % dhe për fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 82 %. Nga krahasimi i përmbledhësës së listë-pagesave me likuidimet nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga për periudhën e audituar. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës si listë-prezencat, urdhrat e veçantë të titullarit. Janë nënshkruar nga drejtuesi kryesor të gjithë listë-prezencat dhe urdhër-shpenzimet për paga. Urdhër shpenzimet janë nënshkruar edhe nga Dega e Thesarit Vlorë. Veprimet e kryera në regjistrin themeltar janë mbështetur në urdhrat e Drejtorit, mbështetur në kontratat dhe për ndërprerjet e marrëdhënieve financiare, mbështetur në VKM nr. 355, datë 07.07.2000" *Për organizimin e dosjes së personelit*". Është mbajtur libri i pagave, në të cilën ishin hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për gjithë periudhën që nga emërimi dhe fillimi i marrëdhënieve të punës të secilit, të rakorduar me të dhënat e listë - pagesave. Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave për vitit 2018- 2019 në lidhje me verifikimin e nivelit të pagave për çdo punonjës dhe arsimimin sipas diplomës, vjetërsinë e punës të përcaktuar në librezat e punës të secilit nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011. Përdorimi i fondeve për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore është bërë duke respektuar legjislacionin përkatës. Në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2013 " *Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 16.4.2009 " *Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*", i ndryshuar janë bërë llogaritjet e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe janë bërë derdhjet e tyre në favor të tatimeve, përjashtuar 1 rast trajtuar tek veprimet e bankës. Po kështu në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 " *Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar janë bërë llogaritjet, ndalesat dhe derdhjet për tatimin mbi të ardhurat në favor të tatimeve. Për periudhën objekt auditimi nuk rezultuan pagesa për orë jashtë kohës normale të punës. Gjithashtu nuk rezultuan pagesa për dhënie shpërblimesh, apo ndihma ekonomike dhe nuk kishte fonde të çelura nga Ministria e Financave nga fondi i veçantë i institucionit, si dhe nuk ka tejkalim në numrin e organiken së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

miratuar, me urdhrin e Kryeministrit. Nga auditimi i dosjeve të personelit (*te cilat mbahen si kopje të identifikuar me ato origjinale që administrohen në AKM*), rezulton se Administrimi dhe inventarizimi i dosjeve ishte bërë në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, të gjitha institucionet e administratës shtetërore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuar, në institucionin e tyre, me të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë si dhe të dhëna të tjera, sipas cilësimeve të këtij vendimi. Për periudhën e audituar është kryer vlerësimi periodike i rezultateve individuale në punë i punonjësve dhe është bashkëlidhur në çdo dosje të nëpunësve. Nga verifikimi i dosjeve për marrjen e statusit të nëpunësit civil për punonjësve aktual të DRM Vlorë rezulton se ligji për shërbimin civil për 4 punonjës i ka gjetur në marrëdhënie pune në këtë institucion, duke përfituar kështu statusin e nëpunësit civil, të cilën u është konfirmuar nga DAP, pasi janë certifikuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ndërsa 4 punonjës të tjera i janë nënshtruar procedurës të konkurrimit.

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë për periudhën 2018-2019 në pagesat e kryera paraqet **pagesa tepër në vjetërsi pune për 2 raste për 3,092 lekë**, konkretisht:

1. Xh. H paguar tepër page vjetërsie për diferencën **800 lekë**, pasi për 4 muaj ka marrë page vjetërsie 7200 lekë nga 7000 lekë që duhej ose tepër 200 lekë/ muaj x 4 muaj ($25 \text{ vjet} \times 2\% = 50\%$ $14,000 = 7000$) për periudhën maj, qershor, korrik, gusht vitit 2018.
2. K. L paguar tepër page vjetërsie për diferencën **2,292 lekë**, pasi në muajin Nëntor 2018 gabimisht i është përlogaritur 7 vjet vjetërsi pune nga 5 vjet që duhej, veprim i sistemuar për vitin 2019 dhe në vazhdim.

III.5. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë, auditim me zgjedhje dhe veprimet në valutë për të gjithë periudhën e kontrollit. Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën, auditim me zgjedhje. Inventarizimi i pronës shtetërore dhe regjistrimi në zyrat e pasurisë.

DRM Vlorë

Administrimi vlerave monetare në arkë.

DRM Vlorë për periudhën objekt auditimi 2018-2019 nuk ka kryer asnjë veprim nëpërmjet arkës, pasi veprimet likuiduese dhe transaksionet financiare janë kryer nëpërmjet bankës.

Administrimi vlerave materiale nëpërmjet magazinës.

DRM Vlorë për vitet 2018-2019 ka administruar mallrat dhe materialet e blera nëpërmjet magazinës, duke i bërë hyrje dhe dalje, në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ligjit nr. 10.296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin” dhe të VKM 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël”.

Ky institucion për vitin 2018 dhe 2019 nuk ka patur tenderime me vlera të mëdha, por ka proceduar me blerje të vogla të artikujve kancelari dhe detergjente në vlerë vjetore respektivisht 690 dhe 821 mijë/lekë, ku janë zbatuar kërkesat e udhëzimit nr. 8 datë 18.01.2018 “Për procedurën e prokurimit publik me vlera të vogla, nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

DRM Vlorë për vitin 2018 dhe 2019 për procedurat me blerje të vogla nuk ka krijuar dosje me dokumentet përkatëse, për pasojë nuk bëhet fjalë për inventarizimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

arkivimin e tyre, por është mjaftuar me lidhjen e tyre tek dokumentet e bankës, në mospërputhje me Udhëzimin nr. 3 datë 03.04.2014, *“Për zhvillimin e Prokurimeve me vlerë të vogël në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik”*, i ndryshuar ku thuhet:

“Autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1 ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues”, pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.

DRM Vlorë nuk ka mjet transporti dhe aktive të patundshme ndërtesa, pasi administrata është instaluar në zyrë të godinës së Bashkisë, të cilat janë në inventar të kësaj të fundit.

Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhet në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim.

Inventarizimi i pronës shtetërore,

Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, është kryer inventarizimi i mallrave dhe materialeve të institucionit, për vitet 2018 dhe 2019.

Bilanci 2018-2019.

DRM Berat në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit si dhe në hartimin e pasqyrave financiare është bazuar në UMF nr. 2 datë 6.2.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin”* i ndryshuar, në UMF nr. 14, datë 28.12.2006 i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 dhe udhëzimin nr. 10 datë 27.02.2008 *“Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”*. Në këtë institucion kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale dhe kompjuterike. Për periudhën e audituar të viteve 2018 dhe 2019 çdo dokument financiar dhe regjistrim kontabël janë shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik dhe kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë përkatëse bazuar në planin kontabël. Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit. Llogaria e disponibiliteteve në Thesar është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me Degën e Thesarit. Nxjerrja e bilancit financiar është bazuar në azhurnimin e veprimeve financiare dhe rakordimin e llogarive sintetike e analitike, dhe jo ekstra kontabël. Bilancet kontabël të vitit 2018 dhe 2019 janë depozituar në Degën e Thesarit Vlorë brenda afatit ligjor, sipas shkresave nr. 134 date 12.03.2019 dhe nr. 112 datë 27.02.2020.

Banka 2018-2019.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, list pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kundronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit. Llogaria e disponibiliteteve në Thesar është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me Degën e Thesarit. Dokumentacioni bazë që pasqyron veprimet e kryera me bankë e magazinë është pasqyruar në ditarët përkatës, ku veprimet janë kryer me bankë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

magazinë dhe me listë-pagesa. Për periudhën e audituar për vitet 2018 dhe 2019, rezultoi se kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë që përcakton plani kontabël sipas klasifikimit buxhetor.

Për periudhën 2018-2019 me veprimet e bankës **DRM Vlorë ka likuiduar vlerën 45,304 lekë**, sipas urdhër shpenzimeve nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 25, nr. 26, nr. 27, nr. 28, nr. 29, nr. 30, datë 25.06.2019, për gjoba të vendosura **për vonesa në derdhjen e tatimit dhe sigurimeve shoqërore** nga fondet e institucionit, në vend që të likuidohej nga personat përgjegjës nga specialisti i financës Ll. H dhe drejtori i DRM Vlorë K. L, siç përcaktohet në shkresat e DTS nr. 12718/1,2,3,4, datë 27.11.2018. Lidhur me këtë problem disponohet dhe udhëzimi i MF nr. 1/3 datë 11.09.2019 “Për një ndryshim të udhëzimit nr. 1 datë 17.01.2019 për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 114 dhe 115, ku përcaktohet:

.....thesari pengon pagat në rast mos pagese të tatimit mbi të ardhurat dhe sigurimeve shoqërore.....

Observacion: DRM Vlorë ka bërë observacion për aktverifikimin nr.1 dhe për projektraportin. **Qëndrimi i grupit auditues:** Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë pjesërisht duke reflektuar në raportin përfundimtar auditimit.

Po kështu Observacioni i DRM Vlorë (P. T) nr. 1325, datë 03.09.2020 qëndron dhe merret parasysh duke reflektuar në raportin përfundimtar auditimit.

DR ISHMPUT Vlorë

Administrimi vlerave monetare në arkë.

DR ISHMPUT Vlorë për periudhën objekt auditimi 2018-2019 nuk ka kryer veprime me arkës, pasi veprimet likuiduese dhe transaksionet financiare janë kryer nëpërmjet bankës.

Veprimet me bankën për vitin 2018 dhe 2019.

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të bankës të DR ISHMPUT Vlorë për vitin 2018 dhe 2019, rezultoi se veprimet e bankës janë kontabilizuar, azhurnuar periodikisht në ditarin përkatës. Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” dhe me UMF. Likuidimet nëpërmjet bankës në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues.

Nga auditimi i veprimeve të bankës u konstatuan **disa mangësi dhe shkelje me efekte financiare** për vlerën **320,647 lekë**, nga kjo:

-vlera **271 mijë lekë**, pagesë e kryer për të njëjtin vend pune, me efekt negativ në buxhetin shtetit,

pasi për 6 muaj (Gusht 2017 deri Janar 2018) E. B ka qenë i larguar nga puna, dhe gjatë kësaj kohe në vendin e tij është punësuar dikush tjetër. Në muaji Dhjetor të vitit 2017 ka dal vendimi i komisioneri të shërbimit civil, nr.239 datë 26.12.2017, i cili ka vendosur që E. B të paguhet për 6 muaj që është hequr nga puna, pagesë e cila është kryer sipas Urdhër shpenzimit nr.8, datë 06.03.2018, urdhrit nr.27 dhe nr.28, datë 23.01.2018 të z. E. A ish-Kryeinspektorit të ISHMPUT Tiranë, aktit administrativ nr.266, datë 14.08.2016.

- vlera **48 mijë lekë** (gjoba) të likuiduara për vonesa në derdhjen e kontributeve sigurimeve shoqërore, sipas urdhër shpenzimeve nr. 77, 78, 79 dhe 80, datë 29.10.2019.

Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, me Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me pikën 62 të UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Observacion: *ISHMPUT Vlorë ka bërë observacion për akt konstatimin nr. 3 mbi konstatimin e grupit të auditimit.*

Qëndrimi i grupit auditues: *Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë pjesërisht duke reflektuar në raportin përfundimtar auditimit.*

Administrimi vlerave materiale nëpërmjet magazinës.

DR ISHMPUT Vlorë për vitet 2018-2019 ka administruar mallrat dhe materialet e blera nëpërmjet magazinës, duke i bërë hyrje dhe dalje, në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ligjit nr. 10.296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin” dhe të VKM nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël”. Ky institucion për vitin 2018 dhe 2019 nuk ka pasur tenderime me vlera të mëdha, por ka proceduar me blerje të vogla të artikujve kancelari dhe detergjente në vlerë vjetore respektivisht 690 dhe 821 mijë/lekë, ku janë zbatuar kërkesat e udhëzimit nr. 8 datë 18.01.2018 “Për procedurën e prokurimit publik me vlera të vogla, nenit 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Administrimi i karburantit, vajrave lubrifikante, gomave, filtra etj.

DR ISHMPUT Vlorë për vitin 2018 dhe 2019 disponon **4 mjete transporti** sipas bilancit kontabël dhe inventarit fizik, përkatësisht: Automjeti VL 9608 B, KV 3693 B, TR 0757 dhe EL 5068 B. Karburanti i blerë për vitin 2018 dhe për vitin 2019 është në limite të vogla dhe është bërë hyrje në magazinë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 53 date 26.10.2018, nr. 61 date 15.11.2018, nr. 75 date 21.12.2018, nr. 16 date 11.03.2019, nr. 25 date 12.04.2019, nr. 36 date 08.05.2019, nr. 55 date 29.07.2019, nr. 75 date 29.10.2019 dhe nr. 100 date 12.12.2019.

Për vitin 2018 dhe 2019 kanë munguar fletëdaljet, fletudhëtimet, normativat e karburantit sipas automjeteve, përkatësisht: Automjeti VL 9608 B, KV 3693 B, TR 0757 dhe EL 5068. Flet daljet e karburantit duhej të bëheshin ditore, sipas nevojave për lëvizje, në urdhrat ditore të kryeinspektorit, çka nuk disponohen dhe nuk bëhet fjalë për shoqërimin e tyre me autorizimet përkatëse. Rakordimi për vitin 2018 dhe 2019 për makinat e DR ISHMPUT Vlorë nuk është kryer për km e përshkuara krahasuar me furnizimet dhe normativat e karburantit, për efekt të argumentimit të harxhimit të karburantit të tërhequr, pasi nuk disponohen fletudhëtime dhe normativa. Për vitin 2018 dhe 2019 shpenzimet për goma, filtra dhe vajra lubrifikante për automjetet e ISHMPUT Vlorë nuk shoqërohen me normativat ligjore për konsumin e tyre. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, dhe ngarkon me përgjegjësi financierin, magazinieren K. R dhe drejtuesit e mjeteve.

Observacion: *ISHMPUT Vlorë ka bërë observacion nr. 1101, datë 06.08.2020 për akt konstatimin nr. 3 dhe observacionin e komisionit blerjeve vogla A. B, A. C dhe N. L mbi konstatimin e grupit të auditimit.*

Qëndrimi i grupit auditues: *Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, e merrë në konsideratë duke reflektuar në raportin përfundimtar auditimit.*

Nxjerrje jashtë përdorimit.

Sipas urdhrit ministrit Mjedisit nr. 235 date 04.7.2017 për ngritjen e komisionit për nxjerrje jashtë përdorimit të mjeteve motorike, me komision të përbërë nga V. B, L. K, F. P, E. Sh, A.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

D dhe M. A, i cili ka nxjerrë jashtë përdorimit 1 automjet, 1 skaf peshkimi dhe 11 motorra e motoçikleta për vlerën 4,219,444 lekë, sipas procesverbalit datë 25.07.2017.

DR ISHMPUT Vlorë ka evidentuar dhe vlerësuar këto mjete si të pa vlera, sipas relacionit dhe procesverbalit vlerësimit datë 15.06.2017 të komisionit të përbërë nga Q. Z, F. I, A. C, N. L, V. F, E. H, i ngritur sipas urdhrit Kryeinspektorit E. H nr. 8 date 29.05.2017.

Vlera 4,219,444 lekë është pasqyruar në bilancin e vitit 2018, pasqyra “*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*”, formati nr. 7/a , llogaria 215 “*mjete transporti*” tek zëri “*pakësime*”, kolona “*nxjerrë jashtë përdorimit*”.

Sa më sipër konstatohet se Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë ka shkarkuar nga kontabiliteti mjetet motorike jashtë përdorimit, për vlerën 4,219,444 lekë (1 automjet, 1 skaf peshkimi, 11 motorë). Në këtë procedurë konstatohet se, praktika dokumentare nuk është e plotë, pasi në procesverbalin e vlerësimit nuk paraqitet asnjë përlllogaritje mbi gjendjen historike të aktiveve, amortizimin, si dhe pse është vendosur për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre. Pas këtij veprimi nuk rezulton të jetë ngritur ndonjë Komision për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me Ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, por janë bërë dalje Drejtorisë së Rezervave Shtetërore Vlorë, për të cilat disponoheshin vetëm fletë-hyrja dhe fletë-dalja e dy institucioneve. Theksojmë se mjetet motorike janë bërë dalje të pa çmontuara dhe ngarkohen me përgjegjësi **anëtarët e komisionit e vlerësimit, Q. Z, F. I, A. C, N. L, V. F, kryeinspektori E. H** (sipas urdhrit nr.8 datë 29.05.2017 dhe procesverbalit date 15.06.2017).

Inventarizimi i pronës shtetërore,

Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, është kryer inventarizimi i mallrave dhe materialeve të institucionit, për vitet 2018 dhe 2019, sipas urdhrit nr. 567, datë 30.12.2018 dhe nr. 567, datë 30.12.2019 “Për inventarizimin dhe krijimin e komisionit”.

Bilanci vitit 2018 dhe 2019 i ISHMPUT Vlorë

ISHMPUT Vlorë në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit si dhe në hartimin e pasqyrave financiare është bazuar në UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin” i ndryshuar, në UMF nr. 14, datë 28.12.2006 i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 dhe udhëzimin nr. 10 datë 27.02.2008 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”. Kontabiliteti mbahet me mënyrën manuale dhe kompjuterike. Për vitin 2018 dhe 2019 çdo dokument financiar dhe regjistrim kontabël janë shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik dhe kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë përkatëse bazuar në planin kontabël. Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit. Llogaria e disponibiliteteve në Thesar është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me Degën e Thesarit. Nxjerrja e bilancit financiar është bazuar në azhurnimin e plotë të veprimeve financiare si dhe rakordimin e llogarive sintetike e analitike, dhe jo ekstra kontabël. Bilancet kontabël të vitit 2018 dhe 2019 janë mbyllur dhe depozituar në Degën e Thesarit Vlorë brenda afatit ligjor, sipas shkresave nr. 107 date 27.02.2019 dhe nr. 64 datë 27.02.2020.

Nga auditimi u konstatua se: **Të ardhurat për vitin 2018 në vlerën 9,851,000 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 9,205,000 leke nuk janë kontabilizuar në bilancin financiar 2018 dhe 2019, pasqyra ardhurave formati nr. 2, llogaria 7115 “gjoha, kamatëvonesa etj” kap. III “të ardhura jo tatimore”, por është mjaftuar me një evidencë vjetore bashkëngjite bilancit, në**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, çka bën përgjegjës financiarin Q. Z.

III.6. Mbi zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, si dhe dhënia e mendimit për pajisjen e subjektit me leje mjedisore. Mbi zbatimin e procedurave ligjore për pajisjen e subjektit me autorizim dhe pëlqim mjedisor dhe Pika nr.7 e Auditimit: Mbi zbatimin e procedurave të vetëmonitorimit dhe monitorimit të mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi. Mbi auditimin e dosjeve mjedisore.

1. Në Bashkinë Vlorë dhe Himarë, gjatë vitit 2017-2018, janë hapur për herë të parë dhe janë aktive deri më 31.12.2018, 222 **biznese**, të cilat nuk janë të pajisura me leje mjedisore, kryesisht të tipit B dhe C.

➤ Sa më sipër janë **150 subjekte** të cilat nuk janë pajisur me leje të tipit C;
➤ Janë **72 subjekte**, të cilat duhet të jenë të pajisura me leje të tipit B, dhe që kanë ndikim të lartë në mjedis, por që nuk janë pajisur me leje mjedisore. **(pasqyruar në tabelën nr. 1, në aneks: Subjekte pa leje mjedisore)**

3. Theksojmë se nga DRM Vlorë nuk është marrë asnjë masë për njoftimin e këtyre subjekteve, si dhe për njoftimin e DRISHMPUT Vlorë, për inspektimin dhe vendosjen e sanksioneve sipas përcaktimeve ligjore.

4. Konstatohet se DRM Vlorë nuk ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë për subjektet të cilat nuk kanë paguar tarifën vjetore, por është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve, të cilat edhe pas njoftimit nuk e kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.

Leje Mjedisore viti 2018

1. Subjekti “Erald Ademi”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 103**, datë 17.07.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “*Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;

-Mungon kontrata për marrjen me qera të vendit ku ndodhet objekti (instalimi), administrohet vetëm fatura e pagesës së qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit, e cila është e vitit 2017, dhe jo 2018;

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit;**

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore;

-Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda çdo 6 mujori (janar 2019; korrik 2019);



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 644 prot., datë 02.09.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit, por nga DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penalitetit, *duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës;*

Në total të ardhurat e munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit janë 32,000 lekë.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nënin 25 pika 6, nenin 27 shkronja b, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar; përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847 prot., datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit te tipit C”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, nr. 452, datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”. Për këto arsye nuk duhet të ishte miratuar leja mjedisore, e më pas në vazhdimësi, kjo leje duhet të ishte revokuar, për mos përmbushje të detyrimeve ligjore të kushteve të lejes mjedisore.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z. B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj.M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19 prot., datë 10.01.2018.

2. Subjekti “M N”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, ***me nr. Identifikimi të Lejes 119***, datë 16.08.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “*Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit, mermerit*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;

-Mungon kontrata për marrjen me qira të vendit ku ndodhet objekti (instalimi), administrohet vetëm marrëveshja e lidhur midis palëve, për marrjen me qira të ambientit, për të cilin nuk në atë periudhë nuk ka patur dokument që vërteton pronësinë e tij, por që kjo pronë ka qenë në proces legalizimi, dhe referuar përcaktimeve ligjore në nenin 83 dhe nenin 659, të Kodit Civil, në këtë rast nuk kemi me të bëjmë me një veprim ligjor, por me një marrëveshje midis palëve, e cila nuk prodhon efekte ligjore;

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Nuk është kryer procesi i VNM paraprake, pasi në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Shtojcën 2 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, ky instalim përfshihet në projekte që i nënshtrohen VNM-së paraprake, ***dhe si pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 30,000 lekë, tarifa për moskryerjen e VNM-së paraprake.***

- Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, për raportin e zhurmave nga Instituti i Shëndetit Publik;

- Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 11 pika 1, të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, për dokumentacionin shoqërues, në të cilin tregohen zhurmata që çlirojnë makineritë/pajisjet që do të përdori subjekti; Për këto arsye nuk duhet të ishte miratuar leja mjedisore;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Në total të ardhurat e munguara me efekt dëm ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit janë 30,000 lekë.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”; Përcaktimet ligjore të bëra në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit te tipit C”; Përcaktimet ligjore të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; Përcaktimet ligjore të Udhëzimit të përbashkët nr. 7938, 17.07.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z. B. A (Anëtar i komisionit) dhe z. Xh. H (Anëtar i komisionit) sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19 prot., datë 10.01.2018.

3. Subjekti “O Shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 11**, datë 16.03.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Furnizimi me karburant dhe GLN i makinave në një stacion të furnizimit me karburant, Vlorë”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;

-Në informacionin e pasqyruar në kërkesën e bërë për leje mjedisore, nuk përputhet informacioni i dhënë nga subjekti, me atë të pasqyruar në fotot e bëra të subjektit dhe ambientit rreth tij, pasi në informacionin e pasqyruar, subjekti deklaron se pika e karburantit nuk është pranë zonave/ambienteve të banuara, ndërkohë që nga fotot pasqyrohet e kundërta

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda 3 mujorit të parë të vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit;**

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore;

-Megjithëse ky subjekt rezulton debitor, për arsye se nuk ka kryer pagesën e tarifës vjetore të lejes, përsëri në datë 15.10.2019, i miratohet kërkesa për leje tjetër mjedisore, nga DRM Vlorë.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nën 25 pika 6, nenin 27 shkronja c, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit te tipit C”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, nr. 452, datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj.M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19 prot., datë 10.01.2018.

4. Subjekti “O. Shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 10**, datë 16.03.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Furnizimi me karburant dhe GLN i makinave në një stacion të furnizimit me karburant, Sarandë”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve lejen;
-Ky subjekt për aplikimin e bërë për pajisjen me lejen mjedisore tipi C, për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të karburantit në Bashkinë Sarandë, ka dorëzuar të njëjtin mandat pagese të tarifës së aplikimit për lejen C, të dorëzuar për aplikimin e bërë për leje mjedisore të tipit C, për stacion karburanti në Bashkinë Vlorë, pra ka përdorur një mandat pagesë për 2 aplikime për leje mjedisore (referuar m/pagesës me nr., P1802021339O914, datë 02.02.2018;

Për sa më sipër aplikimi i bërë nga subjekti, për pajisjen me leje të tipit C, për 1 nga rastet e mësipërme duhej të refuzohej nga DRM Vlorë dhe jo të miratohej leja mjedisore;

Si pasojë e këtyre veprimeve janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 10,000 lekë;

-Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda 3 muajve të parë të vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, ***dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit*** (kjo për pikën e karburantit në sarandë);

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore;

-Subjekti nuk ka dorëzuar raportin e vetë-monitorimit brenda afatit ligjor (1 vit nga miratimi i lejes mjedisore), dhe për këtë DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 107, datë 28.02.2019, nga e cila, nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penaltetit, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë vlera minimale e gjobës; ***trajtuar në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit.***

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, ku në asnjë mënyrë nuk duhet të pranohet i njëjti mandat pagese për dy aplikime për leje mjedisore.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z. K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z. B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj. M. H (Anëtar i komisionit) sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19 prot., datë 10.01.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

5. Subjekti “N. A. T”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 3**, datë 14.02.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Sharimin, fërkimin me rërë, shpimin, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;

-Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, për raportin e zhurmave nga Instituti i Shëndetit Publik dhe mbajtjen e proces-verbalit të konsultimit dhe mendimit të publikut që ndodhet pranë veprimtarisë;

-Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 11 pika 1, të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, për dokumentacionin shoqërues, në të cilin tregohen zhurmat që çlirojnë makineritë/pajisjet që përdor subjekti;

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Nuk është dhënë deklarata e subjektit për respektimin e orarit të qetësisë publike;

-Mungon vlerësimi i konformitetit për pajisjet elektrike që përdor subjekti;

-Nuk janë dorëzuar dëshmitë e punonjësve, për kualifikimin profesional, për përdorimin e makinerive elektrike;

-Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda tremujorit të vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit**;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili nuk ka kryer pagesën;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore, si dhe DRISHMPUT Vlorë për kryerjen e inspektimit dhe vendosjen e penaltetit;

-Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda muajit shkurt të vitit 2019;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 107 prot., datë 28.02.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, nga e cila nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penaltetit, **duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë vlera minimale e gjobës, trajtuar praktika e inspektimit në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit**.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nenin 25 pika 6, nenin 27 shkronja c, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”; Përcaktimet ligjore të nenin 3 dhe nenin 7 të Ligjit nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. prot. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit te tipit C”; Përcaktimet ligjore të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit Përgjithshëm AKM nr.452, datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe z.Xh. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr.19 prot., datë 10.01.2018.

6. Subjekti “A. Ç”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 6**, datë 20.02.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “*Sharimin, fërkimin me rërë, shpimin, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

- Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje;
- Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Udhëzimit Nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, për raportin e zhurmave nga Instituti i Shëndetit Publik dhe mbajtjen e proces-verbalit të konsultimit dhe mendimit të publikut që ndodhet pranë veprimtarisë;
- Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 11 pika 1, të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, për dokumentacionin shoqërues, në të cilin tregohen zhurmat që çlirojnë makineritë/pajisjet që do të përdori
- Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;
- Nuk është dhënë deklarata e subjektit për respektimin e orarit të qetësisë publike;
- Mungon vlerësimi i konformitetit për pajisjet elektrike që përdor subjekti;
- Nuk janë dorëzuar dëshmitë e punonjësve, për kualifikimin profesional, për përdorimin e makinerive elektrike;
- Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda tremujorit të vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit** për vitin 2019;
- Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;
- Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore, si dhe DRISHMPUT Vlorë për kryerjen e inspektimit dhe vendosjen e penaltetit;
- Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin vetë-monitorimit brenda muajit shkurt 2019;
- Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, por nga DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë, për inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, *duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës;*

Në total ardhurat e munguara me efekt negativ ndaj buxhetit shtetit janë 32,000 lekë.

- Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 25 pika 6, nenin 27 shkronja c, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

“Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurms në mjedis”; Përcaktimet ligjore të në nenin 3 dhe nenin 7 të Ligjit nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit të tipit C”; Përcaktimet ligjore të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit Përgjithshëm AKM nr. 452, datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe z.Xh. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr.19 prot., datë 10.01.2018, si dhe z.I. M Kryeinspektor i DRISHMPUT Vlorë për periudhën janar-shkurt, i cili nuk ka marrë asnjë masë në përgjigje të shkresës së dërguar nga DRM.

Observacion: E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Në këtë periudhë nuk kam qenë Kryeinspektor, por ka qenë Kryeinspektor i komanduar z.I. M”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit, e merrë në konsideratë komentin e mësipërm dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

Observacion: Z. I. M me shkresën nr.1129 datë 10.08.2020 ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Për sa i përket rastit që ka ndodhur në shkurt të vitit 2019, ju me ngarkoni me përgjegjësi ish Kryeinspektorin për periudhën janar – 5 shkurt 2019 dhe lini pa përgjegjësi Kryeinspektorin e vërtetë që ka qenë për këtë periudhë. Për periudhën janar-shkurt deri në tetor 2018 DRISHMPUT Vlorë nuk mund të kryente inspektime online sipas Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm me nr. 491, datë 31.08.2017 “Për kryerjen e inspektimeve konforme rregullave ligjor” dhe Vendimit nr. 1 datë 12.10.2017 ku vendosi: Ngarkimin e inspektoratit qendror të koordinojë dhe mbikëqyr punën gjatë ristrukturimit të tyre...”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, nuk e merrë në konsideratë dhe sqaron se:

1. Në konstatimin e mësipërm jemi shprehur për janar-shkurt 2018 dhe jo janar-shkurt 2019;
2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se për periudhën që është cituar nga grupi i auditimit në konstatimin e mësipërm, Kryeinspektor i DRISHMPUT Vlorë ka qenë z. I. M, dhe në dijeninë tonë (referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion) nuk ka Kryeinspektor tjetër.
3. Për Urdhrin dhe Vendimin që ka referuar z.I. M, sqarojmë se në Urdhrin e mësipërm, Inspektorati Qendror ka kërkuar nga të gjithë inspektoratet në Republikën e Shqipërisë, që çdo inspektim të kryhet me dokumentet standarde dhe online. Lidhur me Vendimin nr. 1, datë 12.10.2017 të Komitetit Drejtues për Ristrukturimin e Institucioneve të Varësisë, është përcaktuar se Inspektorati Qendror është përgjegjës për koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së Inspektorateve Shtetërore gjatë procesit të ristrukturimit, si dhe të marrë masa që inspektimet të kryhen me dokumentet standarde dhe online. Pra sa më sipër, në asnjë prej dy dokumenteve të referuara nga z. I. M, nuk përcaktohet/kërkohet që inspektimet të kryhen jo-online.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

7. Subjekti “A. H”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 8**, datë 28.02.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Trajtimi dhe përpunimi i qumështit”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Nuk është kryer procesi i VNM paraprake, pasi në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Shtojcën 2 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, ky instalim përfshihet në projekte që i nënshtrohen VNM-së paraprake, **dhe si pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 30,000 lekë, tarifa për moskryerjen e VNM-së paraprake;**

-Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda muajit Shkurt të vitit 2019;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, por nga DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë, për kryerjen e inspektimit dhe vendosjen e penaltetit, **duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës;**

Në total të ardhurat e munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit janë 60,000 lekë.

Për sa më aplikimi për leje mjedisore nga subjekti i mësipërm duhej të refuzohej.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nenin 25 pika 6, nenin 27 shkronja c, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit të tipit C”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, nr. 452, datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj.M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr.19 prot., datë 10.01.2018, si dhe E. B Kryeinspektor i DRISHMPUT Vlorë për periudhën janar-shkurt, i cili nuk ka marrë asnjë masë në përgjigje të shkresës së dërguar nga DRM Vlorë.

8. Subjekti “A. S”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 5**, datë 14.02.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Thertore”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

-Nuk është kryer procesi i VNM paraprahe, pasi në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Shtojcën 2 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, ky instalim përfshihet në projekte që i nënshtrohen VNM-së paraprahe, **dhe si pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 30,000 lekë, tarifa për moskryerjen e VNM-së paraprahe;**

-Subjekti nuk ka sjellë deklaratën e vlerësimit e konformitetit për vinçin që përdor gjatë ushtrimit të aktivitetit, që lidhet me sigurinë në punë dhe të jetës së punonjësve;

-Nuk është dorëzuar raporti i vlerësimit të zhurmës, referuar edhe proces-verbalit të specialistëve të DRM Vlorë, gjatë monitorimit të subjektit;

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda tremujorit të vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit** për vitin 2019;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;

-Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore, si dhe DRISHMPUT Vlorë për kryerjen e inspektimit dhe vendosjen e penaltetit;

-Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda muajit Shkurt të vitit 2019;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 57 prot., datë 05.02.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, dhe nga DRISHMPUT Vlorë në muajin Maj të vitit 2019 është kryer inspektimi, nga e cila nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penaltetit, **duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 mijë lekë vlera minimale e gjobës, trajtuar praktika e inspektimit në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit.**

Në total të ardhurat e munguara me efekt negativ ndaj buxhetit shtetit janë 62,000 lekë. Për sa më aplikimi për leje mjedisore nga subjekti i mësipërm duhej të refuzohej dhe në vazhdimësi duhej të revokohej leja mjedisore.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nën 25 pika 6, nën 27 shkronja c, nën 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrisë të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. prot. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit të tipit C”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, nr. 452 prot., datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. Lj (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj.M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19 prot., datë 10.01.2018.

9. Subjekti “Y. B”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 130**, datë 13.09.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

- Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje
- Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

- Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të Udhëzimit Nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, për raportin e zhurmave nga Instituti i Shëndetit Publik;

- Nuk pasqyrohet dokumentacioni i regjistrimit të bombolave të gazit, pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”;

- Nuk është dorëzuar dokumentacioni mbi vlerësimin e konformitetit të bombolave të gazit, që lidhet me sigurinë në punë dhe të shëndetit të punonjësve;

- Nuk është dorëzuar kontrata e sigurimit me shoqëri sigurimesh, në rast shpërthimi të bombolave, për dëmet që shkaktohen ndaj palëve të treta dhe mjedisit;

- Nuk është dhënë informacioni i saktë për shkarkimet në ajër, pasi pasqyrohet se nuk ka shkarkime në ajër, për shkak se përdoret energjia elektrike dhe gazi, por ndërkohë subjekti në informacionin e dorëzuar, është shprehur se ka furrë me dru për përgatitjen e picave, çka do të thotë se nga djegia e drurëve çlirohet dioksid karboni, monoksid karboni;

- Nuk është kryer procesi i VNM paraprake, pasi në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Shtojcën 2 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, ky instalim përfshihet në projekte që i nënshtrohen VNM-së paraprake, **dhe si pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 30,000 lekë, tarifa për moskryerjen e VNM-së paraprake;**

- Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit;**

- Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;

- Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore;

- Nga shqyrtimi i regjistrimit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda çdo 6 mujori (janar 2019; korrik 2019);

- Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë nuk ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit, **por nga auditimi i dosjeve të inspektimit, rezulton se pranë këtij subjekti është kryer inspektimi, nga e cila nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penalitetit, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës, trajtuar praktika e inspektimit në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Për sa më sipër kjo aplikimi për leje duhej refuzuar, e më pas në vazhdimësi leja mjedisore e subjektit duhej të revokohej.

Për këto arsye nuk duhet të ishte miratuar leja mjedisore, e më pas në vazhdimësi, kjo leje duhet të ishte revokuar, për mos përmbushje të detyrimeve ligjore kushteve lejes mjedisore.

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nenin 25 pika 6, nenin 27 shkronja c, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit te tipit C”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, nr. 452, datë 08.03.2017 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj.M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr.19 prot., datë 10.01.2018.

10. Subjekti “M shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 4**, datë 31.01.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

- Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje
- Nuk administrohet procesverbalimbledhjes komisionit të shqyrtimit aplikimeve për lejen mjedisore;
- Nuk është dorëzuar vërtetimi teknik i impiantit, që dëshmon sigurinë e tij;
- Nuk dokumentohet pronësia e impiantit;
- Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili nuk ka kryer pagesën;
- Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore;
- Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda çdo 6 mujori (janar 2019; korrik 2019);
- Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 107, datë 28.02.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit, si dhe pranë subjektit është kryer inspektimi, nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penalitetit, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës, **trajtuar praktika e inspektimit në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit.**

▪ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nenin 25 pika 6, nenin 27 shkronja c, nenin 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit të tipit C”; Përcaktimet ligjore të bëra në shkresën e ish Drejtorit Përgjithshëm AKM nr. 452, datë 08.03.2017 “Kërkesë për bashkëpunim”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), B. A (Anëtar i komisionit) dhe M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19, datë 10.01.2018.

11. Subjekti “C. shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 7**, datë 23.02.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë, llumin nga ujërat e ndotura urbane, llumin e cisternave skeptike, mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura, mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

- Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje;
 - Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;
 - Nuk është dorëzuar licenca e subjektit për transportin e mbetjeve;
 - Nuk është dorëzuar dokumenti i transferimit të mbetjeve;
 - Nuk është dorëzuar kontrata e subjektit me landfillin;
 - Nuk është kryer procesi i VNM paraprake, pasi në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Shtojcën 2 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, ky instalim përfshihet në projekte që i nënshtrohen VNM-së paraprake, **dhe si pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 30,000 lekë, tarifa për moskryerjen e VNM-së paraprake;**
 - Nuk janë përcaktuar kushtet në lejen e mjedisit sipas nenit 54 dhe 55 të Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
 - Subjekti i mësipërm nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes mjedisore tipi C, në vlerën 2,000 lekë, e cila duhej të paguhej brenda vitit 2019, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore, **dhe vlera 2,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit;**
 - Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë ka njoftuar subjektin, i cili edhe pas njoftimit nuk ka kryer pagesën;
 - Për shkeljen ligjore të mësipërme DRM Vlorë nuk ka njoftuar QKB, për revokimin e lejes mjedisore, siç është shprehur edhe në shkresën njoftuese të subjektit, në rast se nga ky i fundit nuk përmbushet detyrimi ligjor i pagesës së tarifës vjetore;
 - Nga shqyrtimi i regjistrarit të transferimit/shkarkimit të ndotësve (raporti i vet-monitorimit), si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda 1 viti;
 - Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 174, datë 01.04.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit, dhe nga DRISHMPUT Vlorë është kryer inspektimi pranë këtij subjekti, nga e cila nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e penalitetit, **duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës, trajtuar praktika e inspektimit në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit.**
- Ky aplikim për leje duhej refuzuar, e më pas në vazhdimësi leja mjedisore e subjektit duhej të revokohej.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

■ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra nën 25 pika 6, nën 27 shkronja c, nën 29, shkronja c, pika iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”; Përcaktimet ligjore në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve e Refuzimeve për Lejet Mjedisit tipit C”;

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K L (Kryetar i komisionit të lejeve), z.B. A (Anëtar i komisionit) dhe z.B. A (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr. 19 prot., datë 10.01.2018.

12. Subjekti “J. Ç”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, **me nr. Identifikimi të Lejes 14**, datë 28.03.2018, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor në dosjen përkatëse të lejes mjedisore, u konstatua si më poshtë:

-Nuk administrohet njoftimi i NJQV për dhënie mendimi për aplikimin e subjektit për leje mjedisore;

-Nuk administrohet proces-verbali i mbledhjes së komisionit të shqyrtimit të aplikimeve për lejen mjedisore;

-Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3/d të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, për raportin e zhurmave nga Instituti i Shëndetit Publik;

-Nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të bëra në nën 11 pika 1, të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, për dokumentacionin shoqërues, në të cilin tregohen zhurmat që çlirojnë makineritë që do të përdori subjekti;

-Nuk është dorëzuar dokumenti i dorëzimit të mbetjeve (baterive), si një subjekt i cili gjeneron mbetje jo të rrezikshme;

-Nuk është dorëzuar kontrata e subjektit me transportues/magazinues/riciklues/ të mbetjeve rrezikshme;

-Nga shqyrtimi i regjistratit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda 1 viti;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit, dhe nga DRISHMPUT Vlorë në vitin 2019 është **kryer inspektim, nga e cila nuk është vendosur asnjë masë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit 30,000 lekë, vlera minimale e gjobës, trajtuar praktika e inspektimit në pikën 11 të Projekt-raportit të Auditimit.**

Për këto arsye aplikimi për lejen mjedisore duhej refuzuar, e në vazhdimësi duhej revokuar;

■ Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”; Përcaktimet ligjore të bëra në Kreun IV pika 3, Shtojca 3, pika 1.4, të VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar; Përcaktimet ligjore të VKM Nr. 866, datë 4.12.2012 “për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; Përcaktimet ligjore në urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 109, përcjellë me shkresën nr. 1847, datë 06.10.2015 “Për zbardhjen e Akt-Miratimeve dhe Refuzimeve për Lejet e Mjedisit tipit C”; Përcaktimet ligjore të Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret e procedurat për pajisjen me leje thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”;

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.K. L (Kryetar i komisionit të lejeve), z. B. A (Anëtar i komisionit) dhe znj.M. H (Anëtar i komisionit), sipas Urdhrit të Drejtorit të DRM Vlorë nr.19 prot., datë 10.01.2018.

Për konstatimet e grupit të auditimit, sipas trajtimit të bërë më sipër, mbajnë përgjegjësi, për çështjet në të cilat janë cituar, punonjësit: z.K. L (ish-Drejtor i DRM Vlorë); E. B (ish-Kryeinspektor i DRISHMPUT Vlorë); Xh. H(ish-Specialist i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe e Lejeve Mjedisore); M. H. (ish-Specialiste e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe i Lejeve Mjedisore); B. A (ish-Specialist i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe i Lejeve Mjedisore).

III.8. Mbi auditimin e ushtruar nga DRM në subjektet që me aktivitetin e tyre kanë ndikim të lartë e të mesëm në mjedis.

Nga verifikimi i dokumentacionit pranë DRM Vlorë, rezultoi se DRM Vlorë nuk ka si detyrë ligjore kryerjen e auditimit në subjektet që kanë ndikim të lartë e të mesëm në mjedis.

III.9.Mbi zbatimin e marrëveshjeve me organet e tjera të kontrollit për kryerjen e inspektimeve dhe kontroleve të përbashkëta.

III. Mos vënie në dispozicion dokumentacioni:

Në zbatim të pikave 6, 7, 8, 9 dhe 10, me shkresën nr. 248 prot., datë 22.06.2019, të grupit të auditimit të KLSH-së, u kërkua dokumentacioni, si vijon:

- Dosjet e lejeve mjedisore për vitin 2018-2019;
- Raportet e vetë-monitorimit e sjella nga subjektet e pajisura me lejen C, për 2018-2019;
- Kontrollat e përbashkëta të DRM Vlorë me institucione të tjera me kompetenca inspektimi;
- Dosjet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Nga sa më sipër, pas shkresës së grupit të auditimit drejtuar DRM Vlorë, si dhe komunikimeve nëpërmjet email-it zyrtar të KLSH, konstatohet se nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit, **çka ka penguar grupin e auditimit në realizimin e programit të auditimit**, si vijon:

- Kontrollet e përbashkëta të DRM Vlorë me institucione të tjera me kompetenca inspektimi;
- Proces-verbalet e mbledhjes së Komisioneve të Shqyrtimit/miratimit/refuzimit të aplikimeve për leje mjedisore të tipit C.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15, shkronja dh, e, neni 26, pika 2, të Ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” dhe ngarkojnë me përgjegjësi, personat e poshtëshënuar:

1. K. L, ish-drejtor i DRM Vlorë.
2. Xh. H, ish-Specialist i VNM dhe e Lejeve Mjedisore.
3. M. H, ish-specialiste e Vlerësimit Ndikimit Mjedis dhe i Lejeve Mjedisore.
4. B. A, ish-specialist i Vlerësimit Ndikimit Mjedis dhe i Lejeve Mjedisore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

III.10. Mbi aplikimin e sanksioneve vendosura, regjistrimi e ndjekja e arkëtimit tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit pranë DRM Vlorë, rezultoi se DRM Vlorë nuk ka si detyrë ligjore aplikimin e sanksioneve, regjistrimin dhe ndjekjen e arkëtimit të tyre.

III.11. Kryerja e inspektimeve për zbatimin dhe kontrollin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve nga DR ISHMPUT Vlorë.

- a. Mbi planifikimin vjetor dhe të veprimtarisë së inspektimit si Degë Rajonale e Qarkut Vlorë dhe zbatimi i saj.
 - b. Analiza periodike e punës inspektuese, problematikën e dala dhe zgjidhjet e dhëna në Degën dhe bashkërendimi i punës me ISHMP në nivel qendror.
 - c. Mbi procedurat e ndjekura për dhënien e autorizimeve për inspektim, afati, shpërndarja e burimeve njerëzore, mënyra e raportimit të kryerjes së inspektimit.
 - d. Dokumentacioni i hartuar në procedurat e inspektimit të mjedisit dhe pyjeve, listimi i tyre dhe vlerësimi i formës dhe përmbajtjeve të akteve të inspektimit, përputhshmëria ligjore e tyre për shkeljet konstatuara dhe masa administrative e vendosur, shkalla e shkeljes ligjore.
 - e. Regjistri i inspektimeve dhe analiza e rezultateve, si dhe zbatimi i ligjit “Për kundërvajtjet administrative, mënyra e ekzekutimit të gjobave e masave ndëshkuese e parandaluese.
 - f. Inspektimet e kryera në Degën Doganore Vlorë për parandalimin e dëmtimit të cilësisë së mjedisit apo të përbërësve të tij të veçantë.
 - i. Auditim mbi procedurat e tjera që kryen ky institucion në përmbushje të funksionit të tij.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion DRISHMPUT Vlorë, për vitin 2018, konstatohet se:

Respektimi i përcaktimeve ligjore mbi planifikimin e inspektimeve:

-Për vitin 2018 dhe 2019, sektori i inspektimit të pyjeve në DRISHMPUT Vlorë nuk ka hartuar programin vjetor të inspektimit dhe atë mujor, por e ka kryer këtë funksion në mënyrë rastësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24, Kreu IV në Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH”, pikën 4 dhe 5 të Kreut I të Urdhrit nr. 5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”.

-Inspektimet on-line për sektorin e pyjeve në DRISHMPUT Vlorë kanë filluar në muajin Shtator të vitit 2018, ose rreth 1.5 vite me vonesë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Urdhrin nr. 284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për kryerjen e inspektimeve on-line”;

Për sa më sipër mban përgjegjësi I. M ish Kryeinspektor, z.E B ish Kryeinspektor, E. B ish Kryeinspektor të DRISHMPUT Vlorë për periudhën Janar-Qershor 2018.

Respektimi i përcaktimeve ligjore në kryerjen e inspektimeve në terren dhe sekuestrimin e materialeve:

1. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000018-1, datë 13.09.2018 me inspektorët Eduard Breshanaj dhe Apostol Hasanaj, konstatohet se:

-Listë-verifikimi me nr: ISHMPUT-VL-2018-000018, është plotësuar jashtë afatit të autorizimit të inspektimit, pra në autorizimin e inspektimit përcaktohet se inspektimi do të kryhet brenda datës 13.09.2018, ndërkohë listë-verifikimi është plotësuar në datë 17.09.2018, si dhe në këtë praktik, nuk administrohet autorizimi për shtyrje afati të inspektimit. **Në këtë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

mënyrë ky inspektim konsiderohet i pavlefshëm.

2.Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë pa autorizim inspektimi, me pv.inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000039-2, datë 28.09.2018, me inspektorët E. K dhe A. T, në subjektin A. P, konstatohet se:

- Nuk administrohet autorizimi i inspektimit;
- Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, çka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;
- Referuar listë-verifikimit, konstatohet se subjekti përdor sipërfaqe pyjore në mënyrë të paligjshme;
- Subjekti operon në zonë të mbrojtur;
- Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet asnjë shkelje;
- Në vendimin përfundimtar të inspektimit nuk jepet asnjë masë;
- Nuk është bërë vlerësimi i dëmit të shkaktuar;
- Si pasojë e mos vendosjes së penalitetit ndaj subjektit, ***janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 70,000 lekë*** (vlera e penalitetit minimal referuar nenit 38, pika 1, shkronja k, të Ligjit Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar, si dhe vlera minimale e penalitetit referuar nenit 67, shkronja d, të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar.

3.Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë pa autorizim inspektimi, me pv.inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000041-2, datë 27.09.2018, me inspektorët E. K dhe E. B, në subjektin A. B, konstatohet se:

- Nuk administrohet autorizimi i inspektimit;
- Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, çka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;
- Referuar listë-verifikimit, konstatohet se subjekti përdor sipërfaqe pyjore në mënyrë të paligjshme;
- Subjekti operon në zonë të mbrojtur;
- Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet asnjë shkelje;
- Në vendimin përfundimtar të inspektimit nuk jepet asnjë masë;
- Nuk është bërë vlerësimi i dëmit të shkaktuar;
- Si pasojë e mos vendosjes së penalitetit ndaj subjektit, ***janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 70,000 lekë*** (vlera e penalitetit minimal referuar nenit 38, pika 1, shkronja k, të Ligjit Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar, si dhe vlera minimale e penalitetit referuar nenit 67, shkronja d, të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar.

Observacion: E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Nuk kam qenë pjesë e këtij inspektimi”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit nuk e merrë në konsideratë dhe sqaron se: Nga E. B duhej të bashkëlidhej dokumenti justifikues (autorizim inspektimi) për të vërtetuar prezencën/jo të tij në këtë grup inspektimi.

4.Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë pa autorizim inspektimi, me pv.inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000040-2, datë 27.09.2018, me inspektorët E. K dhe A. H, në subjektin S. G, konstatohet se:

- Nuk administrohet autorizimi i inspektimit;
- Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, ç’ka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

-Referuar listë-verifikimit, konstatohet se subjekti përdor sipërfaqe pyjore në mënyrë të paligjshme; -Subjekti operon në zonë të mbrojtur; -Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet asnjë shkelje; -Në vendimin përfundimtar të inspektimit nuk jepet asnjë masë; -Nuk është bërë vlerësimi i dëmit të shkaktuar; -Si pasojë e mos vendosjes së penaltetit ndaj subjektit, **janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 70,000 lekë** (vlera e penaltetit minimal referuar nenit 38, pika 1, shkronja k, të Ligjit Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar, si dhe vlera minimale e penaltetit referuar nenit 67, shkronja d, të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar.

5. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000018-1, datë 28.09.2018, autorizohen inspektorët N. L dhe E. B për kryerjen e inspektimit pranë subjektit “A”. Në këtë dosje konstatohet se:

-Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, çka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;

-Listë-verifikimi i mbajtur në këtë subjekt, nuk është i plotë, pasi janë disa rubrika që plotësohen, ndërkohë në këtë rast është vetëm një rubrikë e plotësuar;

-Nuk dokumentohet se subjekti ka kontratë për dhënie në përdorim të pjesëve fondit pyjor;

-Nuk dokumentohet nëse subjekti për përdorimin e fondit pyjor ka kryer pagesën përkatëse;

-Nuk dokumentohet nëse subjekti ka lidhur kontratë mirëmbajtjeje dhe përdorimi të zonës pyjore, në përputhje me studimet e miratuara nga KRRTRSH-ja, në bashkërendim me organet e shërbimit pyjor, për sipërfaqen pyjore a kullosore të zënë me ndërtime dhe për territorin që përdorin apo që kanë me qira;

-Nuk dokumentohet nëse fondi pyjor, administrohet e trajtohet sipas planeve të mbarështimit, të inventarizimit dhe të funksioneve të këtij fondi;

-Nuk dokumentohet se vjelja e prodhimeve pyjore kryhet duke mos cenuar mbrojtjen e tokës dhe të elementeve klimatike, ekologjike e shoqërore, dhe nëse subjekti, paraprakisht, ka lejen përkatëse dhe damkimin e drurëve prej organeve të shërbimit pyjor.

-Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet se janë marrë dokumente me qëllim justifikimin dhe mbështetjen e rezultateve të inspektimit;

Observacion: Z.E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Ky subjekt ushtron aktivitet minierar në fondin pyjor-kullosor. Në bazë të Ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 Për pyjet dhe shërbimin pyjor, të ndryshuar, neni 17, për sipërfaqet e fondit pyjor që ushtrojnë veprimtari në këto subjekte. Janë aktivitete që kanë më shumë se 10 vite që ushtrojnë aktivitet dhe janë të pajisur me leje shfrytëzimi”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit nuk e merë në konsideratë dhe sqaron se: Në këtë observacion nuk ka asnjë dokument bashkëlidhur, si dhe konstatimet e grupit të auditimit gjejnë mbështetje në përcaktimet ligjore të bëra në pikat 11 dhe 18 të nenit 21, pikat 4 dhe 9 të nenit 22, pikën 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar.

6. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000027-1, datë 27.09.2018, autorizohen inspektorët N. L dhe E. B. për kryerjen e inspektimit pranë subjektit “N. L. N”. Në këtë dosje konstatohet se:

-Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, çka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;

-Nuk administrohet listë-verifikimi i mbajtur nga inspektorët, me qëllim vlerësimin nga grupi i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

auditimit të punës së kryer në terren nga inspektorët e mësipërm;

-Nuk administrohet vendimi përfundimtar i inspektimit;

-Referuar pv.verbalit të inspektimit të mbajtur nga inspektorët, pasqyrohet tek rubrika këshillimet informacioni si vijon:

“Subjekti u këshillua që të drejtohet në Bashkinë Selenicë pranë zyrës së pyjeve kullotave dhe të filloj procedurën për marrjen e sipërfaqes në përdorim sipas nenit 17 të Ligjit “Për fondin Kullor”.

-Nga sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se ky subjekt ka qenë në përdorim të sipërfaqes kullimore pa marrë lejen e Bashkisë Selenicë, dhe në nenin 17 të Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Personi fizik apo juridik, që merr kullotën për kullotje, sipas nenit 15 të këtij ligji, merr për objektet, që do të ndërtojë në sipërfaqen e marrë, edhe miratimin nga struktura përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki. Për kullotat bashkiake miratimi jepet nga bashkia”;

dhe në nenin 34, pika 1, të Ligjit të mësipërm përcaktohet se, në rastin kur konstatohet kullotja pa kontratë, aplikohet penalteti në vlerën 30,000-50,000 lekë.

-Për sa më sipër, si pasojë e mos vendosjes së penaltetit ndaj subjektit, i cili operon pa kontratën e lidhur me Bashkinë Selenicë, **janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 30,000 lekë.**

Observacion: E B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Si ky subjekt në Qarkun e Vlorës janë shumë dhe këto sipërfaqe janë zënë para 15-20 vitesh” Nga ana jonë kur hasnim në raste të tilla subjektesh i kemi këshilluar që të futeshin në rrugë ligjore dhe t’u drejtoheshin bashkive. **Qëndrimi i grupit auditues:** Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit nuk e merrë në konsideratë dhe sqaron se, komenti bërë më sipër nuk justifikon mosveprimet e grupit të inspektimit ndaj subjektit të mësipërm.

7. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000038-1, datë 25.09.2018, autorizohen inspektorët N. L dhe A H për kryerjen e inspektimit pranë subjektit “D. D”. Në këtë dosje konstatohet se:

-Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, ç’ka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;

-Listë-verifikimi i mbajtur në këtë subjekt, nuk është i plotë, pasi janë disa rubrika që plotësohen, ndërkohë në këtë rast është vetëm një rubrikë;

-Nuk dokumentohet nëse subjekti ka kontratë për dhënien në përdorim të pjesëve të fondit pyjor;

-Nuk dokumentohet nëse subjekti për përdorimin e fondit pyjor ka kryer pagesën përkatëse;

-Nuk dokumentohet nëse subjekti ka lidhur kontratë mirëmbajtjeje dhe përdorimi të zonës pyjore, në përputhje me studimet e miratuara nga KRRTRSH-ja, në bashkërendim me organet e shërbimit pyjor, për sipërfaqen pyjore a kullimore të zënë me ndërtime dhe për territorin që përdorin apo që kanë me qira;

-Nuk dokumentohet nëse fondi pyjor, administrohet e trajtohet sipas planeve të mbarështimit, të inventarizimit dhe të funksioneve të këtij fondi;

-Nuk dokumentohet se vjelja e prodhimeve pyjore kryhet duke mos cenuar mbrojtjen e tokës dhe të elementeve klimatike, ekologjike e shoqërore, dhe nëse subjekti, paraprakisht, ka lejen përkatëse dhe damkimin e drurëve prej organeve të shërbimit pyjor.

-Në procesverbalin e inspektimit nuk pasqyrohet se janë marrë dokumente me qëllim justifikimin dhe mbështetjen e rezultateve të inspektimit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

-Për sa më sipër, nëse nga inspektorët nuk vihet në dispozicion dokumentacioni i referuar nga grupi i auditimit në këtë praktikë, përgjegjësia ligjore bie ndaj tyre, dhe se inspektimi nuk pasqyron gjendjen reale të subjektit.

8. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000026-1, datë 20.09.2018, autorizohen inspektorët N. L dhe A. H për kryerjen e inspektimit pranë subjektit "B. D". Në këtë dosje konstatohet se:

-Listë-verifikimi me nr: ISHMPUT-VL-2018-000026, është plotësuar jashtë afatit të autorizimit të inspektimit, pra në autorizimin e inspektimit përcaktohet se inspektimi do të kryhet brenda datës 20.09.2018, ndërkohë listë-verifikimi është plotësuar në datë 21.09.2018, si dhe në këtë praktik, nuk administrohet autorizimi për shtyrje afati të inspektimit. Ky inspektim konsiderohet i pavlefshëm.

9. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-VL-2018-000019-1, datë 18.09.2018, me inspektorët E. B dhe A. H, në subjektin A. H, konstatohet se:

-Nuk pasqyrohet lloji i aktivitetit që kryen subjekti, çka e bënë të pa mundur për grupin e auditimit, vlerësimin e plotë të respektimit të kërkesave ligjore në kryerjen e inspektimit nga inspektorët e mësipërm;

-Referuar listë-verifikimit, konstatohet se materiali drusor është i pa damkosur, i pa marketuar, pa ngjyrë dhe numër;

-Nuk janë plotësuar dokumentet e transportit të lëndës drusore;

-Nuk ka lejen zhvillimore të miratuar nga KKT, si dhe kontratën e lidhur me bashkinë, për fondin pyjor, pasi ky është një subjekt që ka marrë në përdorim fond pyjor, për ushtrimin e aktivitetit.

-Në pv. e inspektimit pasqyrohet asnjë shkelje dhe asnjë masë.

-Nuk administrohet vendimi përfundimtar i inspektimit.

-Sa më sipër, nga shkeljet e pasqyruara në listë-verifikimin e grupit të inspektimit, ndaj këtij subjekti duhej të aplikoheshin penalitetet dhe pezullimi i tij deri në plotësimin e dokumentacionit. Për shkeljet e konstatuara, vlera minimale e penaliteteve referuar nenit 38 të Ligjit për shërbimin pyjor është dhe nenit 34 të Ligjit për fondin kullor:

b) prerja e drurëve pa damkën e organeve të shërbimit pyjor, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80,000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100,000 (njëqind mijë) lekë;

o) transporti me kamionë i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, i pashoqëruar me lejen tip të transportit, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100,000 (njëqind mijë) lekë;

3. Ushtrimi pa kontratë i veprimtarive në sipërfaqet dhe tokat e fondit kullor dënohet me gjobë nga 150,000 deri në 200,000 lekë.

-Pra sa më sipër, në rast se ndaj subjektit do të aplikoheshin penalitetet në vlerën minimale të tyre, vlera totale e penalitetit për shkeljet e konstatuara do të ishte **310,000 lekë, vlerë e cila është e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.**

Observacion: E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: "Ky subjekt ushtron aktivitet bar-restorant në Parkun Kombëtar të Llogarasë. Inspektimi në këtë subjekt është bërë për të kontrolluar subjektin nëse ka zgjeruar sipërfaqen e marrë në përdorim. Janë subjekte që kryejnë aktivitet prej 20 vitesh dhe lista e këtyre subjekteve dërgohet nga ADZM Vlorë, për vënien në dijeni të Inspektoratit, mbi përdorimin e sipërfaqes së fondit pyjor nga subjekti".

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit sqaron se, ky koment nuk lidhet me konstatimin e mësipërm, dhe nuk e merrë në konsideratë.

10. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr:ISHMPUT-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

VL-2018-000144-1, datë 09.11.2018, autorizohen inspektorët E. R dhe A. T për kryerjen e inspektimit pranë subjektit “SH”. Në këtë dosje konstatohet se:

-Nuk administrohet listë-verifikimi i inspektimit, çka e bënë të pamundur vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore të ndjekura nga grupi i inspektimit në inspektimin e subjektit SHEHU. Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi ligjore inspektorët z.E. R dhe znj.A. T.

Observacion: E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Ky subjekt ushtron aktivitet në tregtimin dhe manipulimin e materialit drusor si dhe në mbarëshkrimin e pyjeve. Sheshi i depozitimit të këtij subjekti nuk është pjesë e fondit pyjor dhe kullësor”. Kur është inspektuar për rastin si më sipër, subjekti nuk i është gjetur material drusor në sheshin e depozitimit, pasi subjekti nuk kishte asnjë kontratë me institucionet që menaxhojnë pyjet dhe kullotat në Qarkun e Vlorës dhe se aktiviteti i subjektit ishte i pezulluar.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të statusit të aktivitetit të subjektit për periudhën e mësipërme në QKB, e merr në konsideratë observacionin dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

11. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr. 000004 datë 18.04.2018, me inspektorët E. B dhe N. L në subjektin “Orejni 2015”, mbajtur Pv., inspektimi nr. 0000019, datë 18.04.2018, në të cilin pasqyrohet informacioni se subjekti dispononte 55 mst dru zjarri të llojit ullishte.

Në këtë dosje konstatohet se: mungon pv. i konstatimit të kundërvajtjes administrative dhe mungon vendimi përfundimtar i inspektimit;

Observacion: E. B. ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Drutë e zjarrit të llojit ullishte nuk i përkasin fondit pyjor kombëtar dhe se janë blerë tek persona privat”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, e merr pjesërisht në konsideratë observacionin dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

12. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr. 0000006 datë 24.04.2018, me inspektorët E. B. dhe L. P në subjektin “P. Ç”, mbajtur Pv., inspektimi nr. 0000021, datë 24.04.2018, në të cilin pasqyrohet informacioni se subjektit i’u gjendën 21 ton sherbelë, 5 ton rigon, dhe se kjo sasi është gjendje nga periudhat e kaluara, ku subjekti e ka grumbulluar në bazë të kontratave me institucionet menaxhuese. I lihet detyrë subjektit të sjelli dokumentacionin justifikues të sasive të mësipërme, brenda afatit ligjor.

Në këtë dosje konstatohet se:

-nuk administrohet pv. i konstatimit të kundërvajtjes administrative;

-nuk dokumentohet nëse subjekti ka dorëzuar brenda afatit ligjor të vendosur, dokumentacionin e kërkuar;

-nuk administrohet vendimi përfundimtar i inspektimit;

-nuk është aplikuar penaltet ndaj subjektit për mosdorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga grupi i inspektimit.

Observacion: E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Subjekti ka dërguar me postë dokumentacionin e mësipërm pranë ISHMPUT Vlorë”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, nuk e merr në konsideratë, pasi nuk është bashkëlidhur asnjë dokumentacion, për të justifikuar veprimet e grupit të inspektimit në inspektimin e mësipërm.

13. Në dosjen e inspektimit në DRISHMPUT Vlorë me autorizim inspektimi nr. 0002163 datë 07.08.2018, me inspektorët E. B, A. H dhe N. L në subjektin “S. M”, mbajtur Proces



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

inspektimi nr. 0001695, datë 07.08.2018, në të cilin pasqyrohet informacioni se subjekti ushtron aktivitet në ekonominë pyjore Mali i Çikës, pajisur me leje minerare dhe me kontratë përdorimi të sipërfaqes pyjore.

Në këtë dosje konstatohet se:

-mungon procesi konstatimit të kundërvajtjes administrative;

-Kontrata për dhënie në shfrytëzim të sipërfaqes pyjore ndërmjet Bashkisë Himarë dhe subjektit, nuk është e protokolluar dhe nuk ka datë kur është nënshkruar, si dhe pa vull të njomë, çka e bënë të pavlefshme.

-nuk administrohet vendimi përfundimtar i inspektimit;

-Për sa më sipër ndaj këtij subjekti duhej të ishte vendosur masa pezullim aktiviteti deri në plotësimin e saktë të dokumentacionit.

Observacion: E. B ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Për rastin e subjektit të mësipërm Bashkia Himarë ka bërë kontratë me subjektin. Kontratat janë verifikuar dhe në bashkinë Himarë, dhe nga ana jonë i është bërë e qartë që nuk duhet të bëjë kontratë përdorimi me subjektin, por të fillojë procedurën për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor, në bazë të legjislacionit”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit nuk e merrë në konsideratë dhe sqaron se: Siç e kemi theksuar edhe më sipër, janë konstatuar mangësi në kontratën e lidhur ndërmjet Bashkisë dhe Subjektit, kontratë, e cila administrohej në dosjen përkatëse të inspektimit si provë materiale.

14. Inspektimi i nisur **mbi ankesën** e bërë ndaj subjektit “Dh. A”, në lidhje me zhurmat që gjeneron ky subjekt gjatë ushtrimit të aktivitetit.

-Me shkresën nr. 130/2 prot., datë 03.08.2018 është përcjellë ankesa pranë DRM Vlorë;

-Me shkresën nr. 453 prot., datë 06.08.2018, ankesa është përcjellë pranë DRISHMPUT;

-Me autorizimin nr. ISHMPUT-VL-2019-000300-1 datë 08.04.2019, është kryer inspektimi pranë subjektit Dh. A, nga inspektorët A. Xh dhe A. H.

-Referuar listë-verifikimit me nr. ISHMPUT-VL-2019-000300, datë 08.04.2019, konstatohet se subjekti nuk ka leje mjedisore të tipit C, **dhe për nivelin e zhurmës nuk pasqyrohet asnjë konstatim, arsye për të cilën ishte ankesa ndaj këtij subjekti.**

-Në pv.e inspektimit me nr. ISHMPUT-VL-2019-000300-2 datë 08.04.2019, pasqyrohet shkelje e nenit 29 të Ligjit për lejet e mjedisit, i ndryshuar, **pra subjekti ushtron aktivitet pa leje mjedisi, dhe vendoset gjobë 30,000 lekë dhe pezullim i aktivitetit deri në pajisjen me leje mjedisore;**

-Në vendimin përfundimtar të inspektimit me nr. ISHMPUT-VL-2019-000300-5 datë 17.04.2019, **ndaj subjektit nuk jepet asnjë masë, si dhe nuk pasqyrohen arsyet përse vlera e gjobës prej 30,000 lekë është hequr.**

-Për sa më sipër vlera prej 30,000 lekë do të konsiderohet e ardhur e munguar ndaj buxhetit të shtetit.

Observacion: I. M me shkresën nr. 1129 datë 10.08.2020 ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Nuk kam qenë pjesë e grupit të inspektimit të mësipërm”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit sqaron se, në asnjë rast në praktikën e mësipërme nuk është shprehur se mbanë përgjegjësi I. M.

Veprime/mosveprimet në praktikën e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 11 dhe 18 të nenit 21, pikat 4 dhe 9 të nenit 22, pika 1 e nenit 26, pika 1 e nenit 38 dhe pika 1 e nenit 40/1, në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar; pika 1 në nenin 27, pika 4 në nenin 29, pikat 3 dhe 4 të nenit 45 si dhe në nenin 54 të Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; nenin 29 të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; pika 3.2, Kapitulli III në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të IQ nr. 13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”.

Inspektime të njoftuara nga DRM Vlorë, për mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore të tipit C:

1. Subjekti “O Shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “Furnizimi me karburant dhe GLN i makinave në një stacion të furnizimit me karburant, Sarandë”.

-Subjekti nuk ka dorëzuar raportin e vetë-monitorimit brenda afatit ligjor (1 vit nga miratimi i lejes mjedisore), dhe për këtë DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 107, datë 28.02.2019.

-Nga auditimi i dosjeve të inspektimit, rezulton se pranë këtij subjekti është kryer inspektimi, si vijon:

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000557-1, datë 15/07/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000557, datë 18/07/2019	Proces-Verbali me nr: ISHMPUT-VL-2019-000557-2, datë 18/07/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000557-5, datë 18/07/2019
Në subjektin tregtar: “O”, NIPT:J63423463I, vendodhja: Sarandë	1.A. Q. 2.S. H.	Nuk pasqyrohet asnjë shkelje, përkundrazi, nga inspektorët është plotësuar listë-verifikimi se subjekti ka paguar tarifën vjetore të lejes dhe ka dorëzuar raportin e vetë-monitorimit.	Nuk ka asnjë shkelje.	Nuk është vendosur asnjë masë

Sa më sipër inspektimi pranë këtij subjekti është kryer në muajin Korrik 2019, ndërkohë që në këtë periudhë ende nuk ishte dorëzuar raporti i vet-monitorimit, të cilin e ka dorëzuar pranë DRM Vlorë protokolluar me nr. 702, datë 02.10.2019, pra në muajin Tetor, **dhe grupi i inspektimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi ky subjekt nuk ka paguar tarifën vjetore si dhe nuk ka dorëzuar raportin e vetë-monitorimit, kjo konfirmuar nga dokumentacioni i DRM Vlorë, i cili administron tarifën vjetore të lejes tipi C.**

Si pasojë e mos vendosjes së penaltetit, **janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt negativ në vlerën 30,000 lekë, për të cilën mbajnë përgjegjësi inspektorët e mësipërm.**

2. Subjekti “N. A. T”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “Sharimin, fërkimin me rërë, shpimin, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”.

-Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda muajit shkurt të vitit 2019;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 107, datë 28.02.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit.

-Nga auditimi i dosjeve të inspektimit rezulton se pranë këtij subjekti është kryer inspektimi si vijon:

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000682-1, datë 27/08/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000682, datë 11/09/2019	Proces-Verbali me nr: ISHMPUT-VL-2019-000682-2, datë 11/09/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000682-5, datë 04/10/2019
--	----------------------	---	---	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Në subjektin tregtar: “N. A. T”, NIPT:L36303202J vendodhja: Vlorë	1.E. H. 2.A. Xh.	Pasqyrohet si shkelje, se subjekti nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes dhe nuk ka dorëzuar raportin e vetë-monitorimit.	Pasqyrohet shkelje e nenit 29, pika 1b, iii, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, dhe vendoset gjobë në vlerën 30,000 mijë lekë.	Nuk është vendosur gjobë, dhe nuk është pasqyruar asnjë arsye përse nuk është vendosur gjobë
--	---------------------	--	--	--

Sa më sipër grupi i inspektimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, **pasi për shkeljet e konstatuara, ndaj këtij subjekti duhej të vendosej gjobë në vlerën 30,000 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 30,000 lekë, për të cilën mbajnë përgjegjësi inspektorët e mësipërm.**

3. Subjekti “A. S”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “Thertore”.

-Nga shqyrtimi i regjistrimit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda muajit Shkurt të vitit 2019;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 57 datë 05.02.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, dhe nga DRISHMPUT Vlorë në muajin Maj të vitit 2019 është kryer inspektimi si vijon:

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000373-1, datë 13/05/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000373, datë 20/05/2019	Proces-Verbali me nr: ISHMPUT-VL-2019-000373-2, datë 20/05/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000373-5, datë 20/05/2019
Në subjektin tregtar: “A. S”, NIPT:L77401208K vendodhja: Vlorë	1.A. T. 2.A. Xh.	Nuk pasqyrohet asnjë shkelje, përkundrazi, nga inspektorët është plotësuar listë-verifikimi se subjekti ka respektuar kërkesat, parimet dhe kushtet e lejes mjedisore, si dhe subjekti ka paguar tarifën vjetore të lejes.	Nuk ka asnjë shkelje.	Nuk është vendosur gjobë.

Sa më sipër grupi i inspektimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, **pasi ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, nuk ka paguar tarifën vjetore**, kjo konfirmuar nga dokumentacioni i DRM Vlorë, i cili administron tarifat dhe raportet e vetë-monitorimit. Si pasojë e mos vendosjes së penaltetit, **janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 30,000 lekë, për të cilën mbajnë përgjegjësi inspektorët e mësipërm.**

4. Subjekti “Y. B”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: “Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysëm të gatshme”.

-Nga shqyrtimi i regjistrimit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda çdo 6 mujori (janar 2019; korrik 2019);

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë nuk ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, **por nga auditimi i dosjeve të inspektimit, rezulton se pranë këtij subjekti është kryer inspektimi, si vijon:**

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000649-1, datë 05/08/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000649, datë 23/08/2019	Proces-Verbali me nr: ISHMPUT-VL-2019-000649-2, datë 23/08/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000649-5, datë 23/08/2019
Në subjektin tregtar: “Y. B”, NIPT:L76806201M	1.A. Xh 2.A. H.	Nuk pasqyrohet asnjë shkelje, përkundrazi, nga inspektorët është plotësuar listë-verifikimi se subjekti ka respektuar kërkesat, parimet dhe kushtet e lejes mjedisore, si dhe subjekti ka paguar tarifën vjetore të	Nuk ka asnjë shkelje.	Nuk është vendosur asnjë masë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

		lejes.		
--	--	--------	--	--

Sa më sipër grupi i inspektimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, **pasi ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, nuk ka paguar tarifën vjetore**, kjo konfirmuar nga dokumentacioni i DRM Vlorë, i cili administron tarifatat dhe raportet e vetë-monitorimit. Si pasojë e mos vendosjes së penaltetit, **janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 30,000 mijë lekë, për të cilën mbajnë përgjegjësi inspektorët e mësipërm.**

5. Subjekti “M. shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant”*.

-Nga shqyrtimi i regjistrimit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda çdo 6 mujori (janar 2019; korrik 2019);

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 107, datë 28.02.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, si dhe pranë subjektit është kryer inspektimi, si vijon:

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000353-1, datë 21/05/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000353, datë 29/05/2019	Proces-Verbal me nr: ISHMPUT-VL-2019-000353-2, datë 29/05/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000353-5, datë 29/05/2019
Në subjektin tregtar: “M. 2017”, NIPT:L77202501R	1.A. Q. 2.I. M.	Nuk pasqyrohet asnjë shkelje, përkundrazi, nga inspektorët është plotësuar listë-verifikimi se subjekti ka respektuar kërkesat, parimet dhe kushtet e lejes mjedisore, si dhe subjekti ka paguar tarifën vjetore të lejes.	Nuk ka asnjë shkelje.	Nuk është vendosur asnjë masë

Sa më sipër grupi i inspektimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, **pasi ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit**, kjo konfirmuar nga dokumentacioni i DRM Vlorë, i cili administron raportet e vetë-monitorimit.

Për sa më sipër, si pasojë e mos vendosjes së penaltetit, **janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 30,000 lekë, për të cilën mbajnë përgjegjësi inspektorët e mësipërm.**

Observacion: I. M me shkresën nr. 1129 datë 10.08.2020 ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: *“Gjatë inspektimit subjekti na ka vendosur në dispozicion lejen mjedisore tipi C, pagesën e tarifës vjetore prej 2,000 lekë si dhe raportin e vetë-monitorimit bashkëlidhur observacionit”*.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, e merr në konsideratë pjesërisht (për mandat-pagesën e tarifës vjetore në vlerën 2,000 lekë) dhe sqaron se:

1. Raporti i vetë-monitorimit nuk është 1 fletë, ka vulën e firmës së licencuar që kryen shërbime të tilla profesionale, si dhe firmën e inxhinierit që ka përgatitur raportin e vetë-monitorimit;

2. Gjithashtu raporti i vetë-monitorimit ka numër protokollit dhe datë të zyrës së protokollit të ish-DRM Vlorë.

Sa më sipër në raportin e vetë-monitorimit (1 fletë) të dorëzuar nga z.I. M, asnjë nga elementët e cituar më sipër nuk ishte.

6. Subjekti “C. shpk”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

përfshirë, llumin nga ujërat e ndotura urbane, llumin e cisternave skeptike, mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura, mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza”.

-Nga shqyrtimi i regjistrimit të transferimit/shkarkimit të ndotësve (raporti i vetë-monitorimit), si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda 1 viti;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë me shkresën nr. 174, datë 01.04.2019, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penaltetit, dhe nga DRISHMPUT Vlorë është kryer inspektimi pranë këtij subjekti, si vijon:

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000139-1, datë 11/03/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000139, datë 15/03/2019	Proces-Verbali me nr: ISHMPUT-VL-2019-000139-2, datë 15/03/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000139-5, datë 15/03/2019
Në subjektin tregtar: “C.”, NIPT:J74818825K	1.A. Q. 2.I. M.	Nuk pasqyrohet asnjë shkelje, përkundrazi, nga inspektorët është plotësuar listë-verifikimi se subjekti ka respektuar kërkesat, parimet dhe kushtet e lejes mjedisore, si dhe subjekti ka paguar tarifën vjetore të lejes.	Nuk ka asnjë shkelje.	Nuk është vendosur asnjë masë

Sa më sipër grupi i inspektimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, **pasi ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit**, kjo konfirmuar nga dokumentacioni i DRM Vlorë, i cili administron raportet e vetë-monitorimit.

Si pasojë e mos vendosjes së penaltetit, **janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 30,000 lekë, për të cilën mbajnë përgjegjësi inspektorët.**

Observacion: Z. I. M me shkresën nr. 1129 datë 10.08.2020 ka paraqitur observacion mbi konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit, ku është shprehur se: “Gjatë inspektimit subjekti na ka vendosur në dispozicion pagesën e tarifës vjetore prej 2,000 lekë si dhe raportin e vetë-monitorimit bashkëlidhur observacionit”.

Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur, e merre në konsideratë pjesërisht (për mandat-pagesën e tarifës vjetore në vlerën 2,000 lekë) dhe sqaron se:

1. Raporti i vetë-monitorimit nuk është 1 fletë, ka vulën e firmës së licencuar që kryen shërbime të tilla profesionale, si dhe firmën e inxhinierit që ka përgatitur raportin e vetë-monitorimit;

2. Gjithashtu raporti i vetë-monitorimit ka numër protokollit dhe datë të zyrës së protokollit të ish-DRM Vlorë.

Sa më sipër në raportin e vetë-monitorimit (1 fletë) të dorëzuar nga z. I. M, asnjë nga elementët e cituar më sipër nuk ishte.

-Ky subjekt është inspektuar përsëri në muajin Nëntor 2019, si vijon:

Inspektimi me Autorizim me nr: ISHMPUT-VL-2019-000775-1, datë 11/11/2019	Grupi i Inspektimit:	Listë-Verifikimi i plotësuar me nr: ISHMPUT-VL-2019-000775, datë 25/11/2019	Proces-Verbali me nr: ISHMPUT-VL-2019-000775-2, datë 25/11/2019	Vendimi Përfundimtar i grupit të inspektimit: ISHMPUT-VL-2019-000775-5, datë 25/11/2019
Në subjektin tregtar: “C.”, NIPT:J74818825K	1.A. Q 2.E. K	Nuk pasqyrohet asnjë shkelje, përkundrazi, nga inspektorët është plotësuar listë-verifikimi se subjekti ka respektuar kërkesat, parimet dhe kushtet e lejes mjedisore, si dhe subjekti ka paguar tarifën vjetore të lejes. Gjithashtu është plotësuar listë-verifikimi se ky subjekt për këtë aktivitet ka leje mjedisore të tipit C me nr PN-7454-06-2014.	Nuk ka asnjë shkelje.	Nuk është vendosur asnjë masë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Në këtë inspektim është kryer kontrolli **për aktivitetin që ka ky subjekt për prodhimin e produkteve plastike**, dhe nga shqyrtimi i dosjes së inspektimit, regjistrit të lejeve/licencave të publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për këtë subjekt, rezulton se ky subjekt nuk ka një licencë të tillë aktive, por licencat/lejet që ky subjekt disponon janë:

➤ **PN-1703-04-2011** (pëlqim mjedisor) “E” - Pëlqim mjedisor për objekt banimi 1-2-kate me papafingo, Data e lëshimit: 18/04/2011, Afati i vlefshmërisë: Pa afat

➤ **PN-6428-04-2018** “C” - Leje mjedisi e tipit C për aktivitetin: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme. Magazinimi dhe/ose trajtimi i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë: llumin nga ujërat e ndotura urbane, llumin e cisternave. Data e lëshimit: 16/04/2018. Afati i vlefshmërisë: Pa afat

➤ **LN-5074-05-2018** (Licencë) “C” Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat e tyre. Data e lëshimit: 14/05/2018. Afati i vlefshmërisë: 14/05/2019 (Përfunduar).

➤ **LN-0208-03-2020** (Licencë) “C” Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. (Auditim mjedisor. Ndikim në mjedis). Data e lëshimit: 02/03/2020. Afati i vlefshmërisë: Pa afat

➤ **LN-4736-03-2018** (Licencë) “C” Shërbimendërhyrëse higjieno-sanitare: ezinfektin, Deratizim, Dezinsektim. Data e lëshimit: 15/03/2018. Afati i vlefshmërisë: Pa afat.

➤ **LN-9289-03-2015** (Licencë) “C” Shërbime profesionale për projekte. Shërbime profesionale për zbatime. Data e lëshimit: 19/03/2018. Afati i vlefshmërisë: Pa afat.

➤ **LN-0627-06-2020** (Licencë) “C” Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove b. Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove c. Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve. Data e lëshimit: 10/06/2020. Afati i vlefshmërisë: 10/06/2025

Pra referuar sa më sipër **ky subjekt nuk disponon asnjë leje mjedisore për aktivitetin e prodhimit të produkteve plastike**, dhe listë-verifikimi është plotësuar në mënyrë fiktive, pasi listë-verifikimi nuk pasqyron realitetin, dhe ndaj këtij subjekti duhet të vendosej gjobë në vlerën **30,000 lekë**, për ushtrim aktiviteti pa lejen e tipit C, **çka përbën të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit**.

7. Subjekti “J. Ç”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, për ushtrimin e veprimtarisë me objekt: *“Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave”*.

-Nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se ky subjekt nuk ka sjellë raportin e vetë-monitorimit, brenda 1 viti;

-Për mos respektimin e këtij detyrimi ligjor, DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit, dhe nga DRISHMPUT Vlorë në vitin 2019 është **kryer inspektim nga grupi i inspektimit z.A. Xh dhe z. A. H**, nga të cilët **nuk është konstatuar asnjë shkelje**, ndërkohë kur ky subjekt **nuk ka plotësuar kushtet e lejes mjedisore, për dorëzimin e raportit të vetë-monitorimit, duke krijuar të ardhura munguara për buxhetin shtetit 30,000 lekë vlera minimale e gjobës**;

Për konstatimet e grupit të auditimit, sipas trajtimit të bërë më sipër, mbajnë përgjegjësi, për çështjet në të cilat janë cituar, punonjësit e mëposhtëm: z. I. M, ish Kryeinspektor; z.E. B, ish Kryeinspektor; z.E. B, ish Kryeinspektor; z.E. B, (ish-Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); z.A. H, (ish-Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); z.E. K, (ish-Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); znj.N. L, (ish-Inspektore në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); z. E. R, Inspektor; A. Q (ish-Inspektore në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); A. H (ish-Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); A. T (ish-Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); S. H



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

(Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT Vlorë); E. H (Inspektor në sektorin e mjedisit në DRISHMPUT).

Nga të dhënat e marra nga sektori i financës rezulton se nga viti 2018 deri në dhjetor të vitit 2019, janë vendosur 66 gjoba në vlerën 19,056,00 lekë, që janë konstatuar me shkelje, nga të cilat kanë likuiduar 15 subjekte në vlerën 1,533,000 lekë ose 12 %.

Në vitin **2018** janë vendosur gjithsej 35 gjoba në vlerën 9,851,000 lekë nga këto 19 janë vendosur nga sektori i inspektimit të mjedisit, 16 nga sektori i inspektimit të pyjeve, dhe kanë likuiduar 9 subjekte në vlerën 1,403,000 lekë ose 14 % e totalit.

Në vitin 2019 janë vendosur 31 gjoba në vlerën 9,205,000 leke, nga të cilat 11 nga sektori i inspektimit të mjedisit dhe nga sektori i inspektimit të pyjeve janë vendosur 17 gjoba, si dhe nga sektori i inspektimit të ujërave janë vendosur 2 gjoba. Nga gjobat e vendosura më sipër konstatohet se janë likuiduar 6 prej tyre në vlerën 130,000 lekë ose 7 % e totalit.

Sa më sipër për periudhën 2018-2019, janë marrë gjithsej 66 vendime dënime administrative “Gjobë” me vlerë 19,056 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 633 mijë lekë (12 gjoba të paguara), ose 3.3% e gjobave të vendosura, duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, në vlerën *18,423 mijë lekë*, si pasojë e mosarkëtimit të tyre, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, në pikën 1 të nenit 40/1, të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për pyjet e shërbimin pyjor”. (*Shif. Aneksi nr. 1 gjobat bashkangjitur si më poshtë*).

Për këto mbajnë përgjegjësi punonjësit e Inspektoratit të Mjedisit, Pyjeve Ujërave, Dega Rajonale Vlorë, A. B ish-Kryeinspektor, z.Xh. H ish-Jurist, A. B ish-Jurist, z.I. M ish-Përgjegjës i sektorit mjedisit, B. B ish-Përgjegjës i sektori të ujërave.

Sipas kërkesës nga grupi i auditimit për vënien në dispozicion të procedurës së administrimit ndjekjes dhe monitorimit, të blloqeve të inspektimit, blloqet e proces-verbaleve, si dhe blloqet e vendimeve administrative mbas hyrjes në fuqi të kontrolleve në sistemin online, me Urdhrin nr.284 date 03.05.2017 për kryerjen e inspektimeve online, u konstatua se janë gjendje 182 blloqe në arkiv, të specifikuar blloqe të inspektimit, blloqe të proces-verbaleve, blloqe të kundravajtjeve administrative si dhe blloqet e vendimeve administrative.

-Nga këto janë dorëzuar 62 blloqe në ISHMPU Qendër Tiranë sipas shkresës me nr.133/2, datë 15.02.2018 dhe nr.1129, datë 20.03.2018.

-Nuk na administrohen fletë-hyrjet sipas viteve, për blloqet e tërhequra nga magazina qendrore e ISHMPUT për të nxjerrë përfundimin e menaxhimit të tyre veprim në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr.1497, datë 19.11.2008, e ndryshuar.

Gjithashtu konstatohet se DRISHMPUT Vlorë nuk nxjerrë urdhër për dorëzimin e blloqeve të inspektimit, konstatimit, vendimit të inspektimit, pasi konsiderohen si letra me vlerë, pasi rezultojnë se janë **182 blloqe** të viteve 2014 deri në vitin 2018, për të cilat nuk ka asnjë informacion nëse këto blloqe i kanë akoma inspektorët, sa janë dorëzuar dhe sa janë gjendje në magazinë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.30. datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin Aktiveve në Njësitë Sektorin Publik”.

Nga sa më sipër mbajnë përgjegjësi z.A. B me detyrë ish-Kryeinspektor në DRISHMPUT Vlorë, Q. Z ish-Specialisti i sektorit të financës, znj. K. R me detyrë ish-Arkiv/protokoll.

Sipas shkresës me nr.38 prot. datë 31.01.2018 Drejtoria e Inspektoratit Vlorë, kanë dërguar informacionin *Prefekturës Vlorë*, për vend grumbullimet e mbetjeve urbane për bashkitë e Qarkut Vlorë. Sipas informacioneve me foto, konstatohet se janë hedhur mbetje në 337 vende, të cilat nuk kanë qenë të miratuara për këtë qëllim. Për këtë fenomen nga DRM Vlorë dhe DRISHMPUT Vlorë, janë kryer inspektime dhe kanë konstatuar rastet në shkelje të ligjit, por



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

në asnjë rast nuk është marrë asnjë masë administrative gjombë ndaj subjekteve të cilat kanë rezultuar në shkelje të ligjit, në kundërshtim me nenin 1.3.3.5 52 dhe neni 69 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” si dhe në kundërshtim me nenin 21 pika 19 dhe nenit 30 e nenit 37 të ligjit 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet e shërbimin pyjor”; neni 4, pika 33, neni 73 pika 1 dhe neni 97 të ligjit nr.111/2012 ,”për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, duke i krijuar buxhetit të shtetit një të ardhur të munguar në vlerën **101,100,000 lekë** ($337 \times 300,000$).

Nga sa me sipër mbajnë përgjegjësi z.A. B me detyrë ish-Kryeinspektor në DRISHMPUT Vlorë, K. L ish-Drejtor i DRM Vlorë.

- Në 362 inspektive janë vendosur 14 gjoba dhe janë konstatuar se janë pajisur me leje mjedisore 156 subjekte dhe 192 subjekte kanë ushtruar aktivitet pa lejen mjedisore përkatëse, për të cilat nga DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë administrative (gjombë) duke i krijuar buxhetit të shtetit një të ardhur të munguar në vlerën 57,600,000 lekë ($192 \times 300,000$ gjoba minimale për mungesën e lejes mjedisore).

Mbi arkivimin e dosjeve të inspektimit:

Në list verifikimin e mbajtur në datën 06.07.2019 (arshivuar në datën 18.02.2020) në subjekti Arjan Stoli ka dy lokale dhe zotëron vetëm një leje mjedisore objekti me nr. prot 99/2 **nuk** ka leje mjedisore, ndërsa objekti me nr. 100 ka leje mjedisore, nga inspektorët nuk është vendosur gjombë.

-Subjekti N. R, praktika e arshivuar me nr. 101, datë 28.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 09.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

-Subjekti Hotel “Dh” 2000, praktika e arshivuar me nr. 102 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet në datën 10.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur as një sanksion.

-Subjekti G. S, praktika e arshivuar me nr. 104 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 10.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur as një sanksion.

-Subjekti Xh. M e arshivuar me nr. 105 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 11.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur as një sanksion.

-Subjekti V. Ll, praktika e arshivuar me nr. 106 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 11.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti A. P, praktika e arshivuar me nr. 107 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet në datën 12.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti J. G, praktika e arshivuar me nr. 108 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 16.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti K. D , praktika e arshivuar me nr. 109 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 16.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti Sh. V, praktika e arshivuar me nr. 110 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 17.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti L. E, praktika e arshivuar me nr. 111 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 18.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORE DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORE, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti T. L, praktika e arshivuar me nr. 112 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 18.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti Dh. 8 A, praktika e arshivuar me nr. 113 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 19.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti E. K, praktika e arshivuar me nr. 114 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 23.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti Ll. N, praktika e arshivuar me nr. 115 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 23.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti E. T, praktika e arshivuar me nr. 117 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 24.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti A. L, praktika e arshivuar me nr. 118 prot 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 24.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti E. Z, praktika e arshivuar me nr. 119 prot. 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 25.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti L. K, praktika e arshivuar me nr. 120 prot. 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 25.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti G. B, praktika e arshivuar me nr. 121 prot. 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 26.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e kostatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti V. B, praktika e arshivuar me nr. 122, datë 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet në datën 29.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti N. R, praktika e arshivuar me nr. 123, datë 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet në datën 09.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi, kanë përshkruar mire te dhënat sipas kolonave përkatëse.

-Subjekti A. B. R, praktika e arshivuar me nr. 124, datë 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 17.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Nga ana e konstatimit nuk ka leje mjedisore, nuk është vendosur asnjë sanksion.

-Subjekti K -S, praktika e arshivuar me nr. 125, datë 18.02.2020 e pa firmosur nga inspektorët, kontrolli kryet ne datën 30.07.2019 me 7 muaj vonesë arshivimi.

Pra konstatohet se 95 dosje, janë ndjekur pjesërisht procedurat në marrjen e autorizimit të inspektimit, deri në përpilimi i proces verbalit, si dhe inventarizimin të tyre, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”

III.12. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimi.

ISHMPUT Vlorë.

Nga Kryeinspektorët e DR ISHMPUT, përgjegjësit mjedisit si dhe përgjegjësit dhe inspektorëve ujërave, nuk është përfshirë për vitin 2018 dhe 2019 inspektimi i Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizimeve njësi vartëse e bashkisë Vlorë, e cila mbulon edhe KUZ. Kjo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

ndërmarrje që ushtron aktivitet në Qarkun e Vlorës me ndikim në mjedis është lënë jashtë planifikimit dhe inspektimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, ku në nenin 62 “Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit” Pika (e), përcaktohet:

kryen kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur. Inspektori i mjedisit mund të kryejë edhe detyra të tjera, të përcaktuara në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit”.

DR ISHMPU Vlorë **nuk ka realizuar inspektimin dhe verifikimin në terren të 3 rrjedhjeve të ujërave të zeza në zonën bregdetare të plazhit publik, në vendin Lungomare Vlorë, të cilat derdhen në det, duke shkaktuar ndotje në dëm të shëndetit komunitetit dhe turistëve.** Për rrjedhojë për vitin 2018 dhe 2019 nuk ka marrë asnjë vendim administrativ “**dënim me gjobë**”, për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”.

Gjithashtu konstatohet mosrespektim të afateve ligjore të kryerjes së inspektimit dhe ri-inspektimit, si dhe mos mbajtje të procesverbaleve duke mos përcaktuar afatet e realizimit të detyrave. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet” e pika 5, e cila përcakton:

“Inspektorati Shtetëror Kompetent i njofton, me shkrim, subjektin të shkeljes, aktin e konstatimit dhe vendos sanksionet brenda 60 ditëve kalendarike nga çasti që ky inspektorat bën konstatimin e kundërvajtjes.”

si dhe me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 17”Afatet e shqyrtimit” i cili përcakton se:

”1. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje.

Për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, rekomandojmë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, u konstatua se:

a. Drejtoria Rajonale e ISHMPUT, Vlorë, ka zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna më parë nga KLSH, sipas shkresës nr. 960/7prot., datë 17.12.2016, konkretisht:

- 2 masa për shpërblim dëmi për vlerën 2,500,000 lekë, nuk janë zbatuar, përkatësisht:

* vlera 500,000 lekë, nuk është kontabilizuar dhe arkëtuar nga K. L, pavarësisht se subjekti pretendon se është falur nga Komisioni Ankimor, sipas vendimit nr.1, datë 23.07.2014, vendim të cilin KLSH e ka cilësuar të pa mbështetur ligjërisht.

* vlera 2,000,000 lekë, nuk është kontabilizuar dhe arkëtuar nga subjekti “G. B”.

- 1 masë të ardhura të munguara, rezulton e zbatuar pjesërisht.

- nga 56 masa organizative të rekomanduara, nuk janë zbatuar 3 rekomandime, janë zbatuar 10 rekomandime, zbatuar pjesërisht 11 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 32 rekomandime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Moszbatimi i rekomandimeve bie ndesh me Urdhërin nr.70, datë 18.04.2006 të Kryeministrit “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Auditit të Brendshëm”, me nenin 30 të Ligjit nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 11-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara, të lëna më parë nga KLSH, sipas shkresës nr.960/7, datë 17.12.2016 dhe akt konstatimit nr.5, datë 28.07.2020.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë, Sektori i financës ka shkarkuar nga kontabiliteti mjetet motorike jashtë përdorimit, për vlerën 4,219,444 lekë (1 automjet, 1 skaf peshkimi, 11 motorë). Në këtë procedurë konstatohet se, praktika dokumentare nuk është e plotë, pasi në procesverbalin e vlerësimit nuk paraqitet asnjë përlllogaritje mbi gjendjen historike të aktiveve, amortizimin, mbi bazën e cilave është vendosur për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre. Pas këtij veprimi nuk rezulton të jetë ngritur ndonjë Komision për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me Ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, por janë bërë dalje Drejtorisë së Rezervave Shtetërore Vlorë, për të cilat disponoheshin vetëm fletë-hyrja dhe fletë-dalja e dy institucioneve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 22-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, Sektori i Financës, të plotësojë dokumentacionin e praktikës së aktiveve, si më sipër. Në procesverbalin e vlerësimit të paraqiten përlllogaritjet e kryera mbi gjendjen historike të aktiveve, amortizimin mbi bazën e të cilave është vendosur për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, si dhe të ndiqen të gjithë hapat ligjore për nxjerrjen e përgjegjësive ndaj personave të ngarkuar me këtë detyrë në komisionet përkatëse.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Dega Rajonale e Inspektoratit Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujërave dhe Turizmit, Vlorë, Sektori i Financës dhe Arkivë-Protokollit, për vitin 2018-2019 në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, nuk ka menaxhuar blloqet/procesverbalet e gjobave dhe konstatimeve, si dhe nuk ka kryer rakordime për hyrje-daljet e blloqeve dhe administrimin e tyre si letra me vlerë, veprime të cilat lënë vend për abuzim (Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, Sektori i Financës dhe Arkivë-Protokollit, të kryej rakordin e blloqeve të gjobave dhe konstatimeve, sipas numrit serial të tyre (ato që janë tërhequr dhe dorëzuar, nga ISHMPUT qendër në magazinën e DRISHMPUT Vlorë dhe tek Inspektorët), të evidentohen personat përgjegjës, të cilët kanë tërhequr dhe kanë pasur në menaxhim dhe administrim këto letra me vlerë, arsyet e mos kryerjes së rakordimeve periodike për blloqet e tërhequra, deri në ngarkimin me përgjegjësi ligjore të tyre.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 50 praktikave të miratimit të lejes mjedisore të tipit C, për 12 subjekte, “E. A”, “M. N”, “O” Shpk në dy praktika të miratimit të lejes mjedisore”, “N. A. T”, “A. Ç”, “A. H”, “A. S”, “Y. B”, “M. shpk”, “C shpk”, “J. Ç”, është konstatuar miratimi i lejes mjedisore në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, në mungesë të pagesës së tarifës së aplikimit, në mungesë të zhvillimit të procedurës së VNM-së, dhe raportit të gjenerimit të zhurmave, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në: Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar; në VKM nr.419, datë 25.06.2014, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis” (Më hollësisht trajtuar në pikat 6 dhe 7, faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, të marrë masat e nevojshme për rishqyrtimin e lejeve mjedisore, për 12 subjektet e mësipërme, dokumentacioni i të cilave ka mangësi në plotësinë dhe saktësinë e tij, të nxirren përgjegjësitë dhe personat përgjegjës, të cilët kanë pasur për detyrë, shqyrtimin, verifikimin dhe miratimin e lejeve mjedisore, deri në ngarkimin me përgjegjësi ligjore të tyre.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, Sektori i Inspektimit të Pyjeve në DRISHMPUT Vlorë, nuk ka hartuar programin vjetor të inspektimit dhe atë mujor, por e ka kryer këtë funksion në mënyrë rastësore, duke mos garantuar plotësisht zbatimin e kuadrit ligjorë në mbrojtjen e mjedisit dhe pyjeve, ndërsa inspektimet online (nëpërmjet portalit e-inspektimi) për sektorin e pyjeve në ish DRISHMPUT Vlorë kanë filluar në muajin Shtator të vitit 2018, ose rreth 1.5 vite me vonesë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; me Urdhërin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për kryerjen e inspektimeve online”; me Urdhërin nr.13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e Manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH”, me Urdhërin nr.5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve” (Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, që për kryerjen e funksionit të inspektimit, të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit për fushat përkatëse të aktivitetit të tyre, si dhe miratimin brenda afateve në përputhshmëri me përcaktimet ligjore, duke ulur numrin e inspektimeve rastësore, të cilat nuk përmbushin plotësisht qëllimin e funksionit të inspektimit në tërësi dhe lënë hapësira për ta kthyer këtë proces në selektiv dhe trajtim jo të barabartë të subjekteve.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 50 praktikave të inspektimit në pyje, është konstatuar se:

- Në 12 raste, janë konstatuar : mos pasqyrimi i llojit të shkeljes dhe sasisë së drurit të transportuar në mënyrë të paligjshme, në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, në vendimin përfundimtar të inspektimit, nuk jepet masa për sekuestrimin e lëndës drusore të transportuar në mënyrë të paligjshme, mosrespektim të kushteve të lejes mjedisore;
- Në 11 raste, nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet nuk janë sjellë raportet e vetë-monitorimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara në kushtet e lejes mjedisore të tipit C, për të cilat nga DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë përgjatë inspektimeve të kryera, pranë këtyre subjekteve;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

- Në 10 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit në pyje, konstatohet se, listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit, nuk është plotësuar saktë sipas çdo rubrike, si dhe në 4 raste prej tyre këto dokumente nuk administrohen në dosjen përkatëse të inspektimit;
- Në 4 raste për subjektet: “A. P”, “A. B”, “S. G.”, “A. H”; nga inspektorët nuk është llogaritur dëmi i shkaktuar në ekonominë pyjore, si pasojë e veprimeve të paligjshme të subjekteve private (prerje të druve pyjor, për të cilat nuk është specifikuar lloji i tyre nga inspektorët, ç’ka e ka bërë të pamundur llogaritjen e tyre nga grupi i auditimit);
- Në një 1 rast inspektimi, në subjektin “C”, SHPK, listë-verifikimi i inspektimit nuk është plotësuar saktë dhe nuk pasqyron realitetin, pasi ky subjekt në kohën kur është kryer inspektimi, nuk ka disponuar asnjë leje mjedisore, ndryshe nga çfarë është pasqyruar nga inspektorët në listë-verifikimin përkatës, konfirmuar kjo edhe nga verifikimi i grupit të auditimit, për lejet dhe licencat e këtij subjekti të publikuara në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në: Pikën 1 të nenit 40/1 të Ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pikën 1/b.i dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”; Pikën 1 shkronja e të nenit 28, pikën 3 dhe 4 të nenit 45 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Urdhërin e Inspektorit Përgjithshëm nr.58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e dokumenteve standarde të inspektimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, të marrë masat e nevojshme për rishqyrtimin e ligjshmërisë së inspektimeve të kryera në rastet e mësipërme, si dhe të nxirren përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

- Të kryhen llogaritjet e dëmit të shkaktuar në ekonominë pyjore, nga subjektet “A. P”, “A. B”, “S. G”, “A. H”, si dhe kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit të shkaktuar prej tyre.
- Nga inspektorët e këtij institucioni, për çdo rast të konstatimit të shkeljeve në ekonominë pyjore, dëmtimet e florës dhe faunës, si pasojë e veprimeve të paligjshme të subjekteve private, të mbahet procesverbali i përlllogaritjes së dëmit të shkaktuar, duke specifikuar dhe llojin e drurit, me qëllim llogaritjen e saktë të dëmit të shkaktuar, si dhe të kërkohet sanksionimi i tyre në përputhje me përcaktimet ligjore.

Menjëherë

6.2.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, Zyra Mjedisore Vlorë të marrë masat e nevojshme për njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (AKP), me qëllim që nga inspektorët e këtij institucioni, dokumentet standarde të inspektimit të plotësohen për çdo rubrikë të përcaktuar, si dhe në rastet kur nuk është e mundur, të pasqyrohen arsyet e inspektorëve për mosplotësimin e tyre. Gjithashtu, çdo dokument standard i inspektimit (përfshirë këtu edhe dokumentet justifikuese të marra nga subjekti), të gjenerohet nga portali e-inspektimi, të inventarizohet me numër rendor dhe të arkivohet në protokollin e institucionit.

6.3.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme dhe të rishqyrtojë saktësinë dhe vërtetësinë e veprimeve të ndjekura nga inspektorët në praktikën e inspektimit në subjektin “C” SHPK, (*prodhim i produkteve plastike*), duke marrë të gjitha masat e nevojshme të parashikuara në legjislacionin në fuqi, nga vendosja e penaltetit deri në pezullimin e aktivitetit të subjektit, si dhe ngarkimin e inspektorëve me përgjegjësi ligjore për veprimet dhe mosveprimet në inspektimin e subjektit të mësipërm.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DRM Vlorë, marrë nga kjo e fundit në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë sipas kërkesës së Grupit të Auditimit të KLSH, për subjektet aktive në treg, si dhe numrit të lejeve mjedisore lëshuar nga Drejtoria e Mjedisit, që i përkasin Bashkive Vlorë e Himarë, rezultojnë se në këtë territor ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me leje mjedisore 222 subjekte, kryesisht të tipit B dhe C, konkretisht: 150 subjekte që nuk janë pajisur me leje të tipit C, dhe 72 subjekte që nuk janë pajisura me leje të tipit B, për të cilat nga DRM Vlorë dhe DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë, për pajisjen e tyre me leje mjedisore, duke rritur mundësitë e lënies jashtë mbikëqyrjes dhe kontrollit të nivelit të ndotjes mjedisore, akustike, me impakt negativ në aktivitetin e turizmit të kësaj zone, klasifikuar në zonë të mbrojtur dhe me përparësi në zhvillimin e turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikat 6 dhe 7, faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Himarë, të marrë masa urgjente për planifikimin e inspektimeve përgjatë vijës bregdetare, të mbikëqyrë dhe inspektojë aktivitetin mjedisor gjatë kësaj zone të subjekteve që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me leje mjedisore, kryesisht të tipit B dhe C, duke monitoruar dhe kontrolluar nivelin e ndotjes mjedisore dhe akustike me impakt në turizmin e kësaj zone, të nxirren përgjegjësitë e inspektorëve që mbikëqyrin zonën deri në ngarkimin e tyre me përgjegjësi ligjore.

-Drejtorja Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masa për verifikimin e subjekteve (ato të identifikuar nga Grupi i Auditimit, pasqyruar në tabelën nr. 1 “Anekse” dhe të tjera) si dhe inspektimin e tyre, me qëllim që këto subjekte të ushtrojnë aktivitetin ekonomik në mënyrë ligjore.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (praktikat e inspektimit), është konstatuar se DRISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, duke mos vendosur asnjë penalitet (gjobë) ndaj subjekteve, të cilat kanë hedhur mbetjet e tyre në 337 ambiente të pa miratuara për hedhjen e mbetjeve, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të bëra në nenet 1, 3, 5, 52, 69 të Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar; në nenin 21, pika 19 dhe nenin 30 e 37 të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet e shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe nenin 4 pika 33 të nenit 73, pikën 1 të nenit 97 të Ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 10,110,000 lekë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, për rishqyrtimin e inspektimeve të kryera në 337 rastet e mësipërme, nxjerrjen e përgjegjësiave ndaj inspektorëve, të cilët nuk kanë marrë asnjë masë (paralajmërim, gjobë, ndalim të ushtrimit të aktivitetit) ndaj subjekteve (private/publike) që hedhin mbetje në vende të pa miratuara nga Bashkitë e Qarkut Vlorë, Qarkut Fier dhe Qarkut Gjirokastrë dhe ngarkimin e tyre me përgjegjësi ligjore, për mos ushtrim të detyrave funksionale.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë për vitin 2018 dhe 2019, nuk ka përfshirë inspektimin e Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime, njësi vartëse e Bashkisë Vlorë, e cila mbulon edhe KUZ me ndikim të lartë në mjedis, duke e lënë jashtë planifikimit dhe inspektimit, në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, i ndryshuar. Lënia jashtë planit e këtij subjekti, i cili mbulon një vijë të gjatë bregdetare, në një nga zonat më turistike



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

në vend, ka lënë jashtë mbikëqyrjes dhe kontrollit menaxhimin e ujërave të zeza, mundësitë e shkarkimit në det në mënyrë të jashtëligjshme, si dhe verifikimin e investimeve dhe ndërhyrjeve përgjatë punimeve civile të veprave të ndërtuara së fundmi në zonën e plazhit publik “Lungomare”, Vlorë, mbi rrjetin e kanalizimeve, veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bera seksionin 2 të nenit 62-66 në Ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 12, faqet 56-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe Ndërmarrjen e KUZ, të marrë masa urgjente për planifikimin e inspektimeve përgjatë vijës bregdetare, të mbikëqyrë dhe inspektojë menaxhimin e ujërave zeza, të evidentojë dhe parandalojë raste të mundshme të shkarkimit në det në mënyrë të jashtëligjshme duke i sanksionuar, si dhe verifikimin e investimeve dhe ndërhyrjeve, mbi rrjetin e kanalizimeve, në zonën e plazhit publik Lungomare Vlorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë, rezulton se nga 362 subjekte të inspektuara përgjatë vitit 2019, kanë rezultuar pa leje mjedisore 192 subjekte, për të cilat nuk është marrë masë administrative gjobë, duke krijuar *të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 57,600 mijë lekë* (192 subjekte * 300,000 lekë që është vlera minimale e gjobës që duhej të vendosej), duke vepruar në kundërshtim me nenin 1, 3, 5, 52 dhe 69 të Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 40-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, për rishqyrtimin e inspektimeve të kryera në 192 subjektet, të nxirren përgjegjësitë dhe personat përgjegjës deri në ngarkimin me përgjegjësi ligjore të tyre, për mos aplikimin e masave parandaluese dhe penalizuese në vlerën 57,600,000 lekë, ndaj subjekteve të konstatuara pa leje mjedisore.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë administrative dhe ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën *1,503 mijë lekë*, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga 474 subjekte të pajisur me leje mjedisore në vitet 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë paguar tarifat e përcaktuara në shumën *962 mijë lekë*, konkretisht:

- Nga 116 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2017, por që aktiviteti i tyre i shtrin efektet edhe në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 86 subjekte, *duke krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 172,000 lekë*. Gjithashtu, konstatohet se edhe në vitin 2019, vetëm 14 prej tyre kanë paguar tarifën, ndërsa 72 subjektet e tjera nuk kanë paguar, në vlerën 144,000 lekë, pra në total për dy vitet *janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 316,000 lekë*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

- Nga 140 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2018, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 118 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhet e shtetit në vlerën 236,000 lekë.*

- Nga 218 subjekte të cilat janë pajisur me leje mjedisore të tipit C në vitin 2019, konstatohet se nuk kanë paguar tarifën vjetore 205 subjekte, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhet e shtetit në vlerën 410,000 lekë.* Në të gjitha rastet nga titullari i DRM Vlorë, në rolin e nëpunësit autorizues, nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 5 të VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 17-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

1.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit, *për vlerën 962 mijë lekë,* si pasojë e mos pagesës së tarifës vjetore të lejes mjedisore të tipit C, (2 mijë lekë/leje mjedisore), sipas tabelave nr. 2-4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në 5 praktika të miratimit të lejes mjedisore të tipit C, për subjektet “M. N”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me nr. identifikimi të Lejes 119; datë 28.02.2018; “A. H”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me nr. identifikimi të Lejes 8, datë 28.02.2018; “A. S”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me nr. identifikimi të Lejes 5, datë 14.02.2018; “Y. B”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me nr. identifikimi të Lejes 130, datë 13.09.2018; “C SHPK”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi C, me nr. identifikimi të Lejes 7, datë 23.02.2018, është konstatuar se nuk është kryer procesi i vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Shtojcën 2 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e shtetit, *në vlerë 150 mijë lekë (Më hollësisht trajtuar në pikat 6 dhe 7, faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme për përfshirjen e subjekteve të mësipërme në procedurën e VNM si dhe arkëtimin e tarifës së aplikimit për procedurën e VNM-së, në vlerën *150 mijë lekë* për lejet e cituara më sipër.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve nëpërmjet bankës, për periudhën 2018-2019, konstatohet se DRM Vlorë ka likuiduar vlerën 45 mijë lekë (gjoba), për mosrespektim të afateve në derdhjen e tatimit dhe sigurimeve shoqërore, sipas urdhër shpenzimeve nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 25, nr. 26, nr. 27, nr. 28, nr. 29 dhe nr. 30, datë 25.06.2019, duke mos nxjerrë përgjegjësinë dhe shkaktarët e kësaj gjobe, pasi kjo gjobë ka ardhur për mungesë angazhimi të DRM, veprime këto në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkresën e DTS nr. 12718/1,2,3,4, datë 27.11.2018, me kërkesat UMF nr. 1/3 datë 11.09.2019 “Për një ndryshim të udhëzimit 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin buxhetit 2019”, pika 114 dhe 115 dhe me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 22-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerës 45 mijë lekë, përkatësisht nga z.K. L me detyrë ish-Drejtor i DRM Vlorë dhe zj.Ll. H, me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës, me nga 22,652 lekë/secili, për likuidim të gjobave të vendosura për vonesa në derdhjen e tatimit e sigurimeve shoqërore nga fondet e DRM Vlorë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2021

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës të kryera nga Drejtoria Rajonale ISHMPUT Vlorë u konstatuan mangësi dhe shkelje me efekte negative financiare për vlerën 320 mijë lekë, nga kjo:

- vlera 271 mijë lekë, pagesë e kryer për të njëjtin vend pune, me efekt negativ në buxhetin shtetit, pasi për 6 muaj (*Gusht 2017 deri Janar 2018*) E. B ka qenë i larguar nga puna, dhe gjatë kësaj kohe në vendin e tij është punësuar dikush tjetër. Në muaji Dhjetor të vitit 2017 ka dal vendimi i komisioneri të shërbimit civil, nr.239 datë 26.12.2017, i cili ka vendosur që E. B të paguhet për 6 muaj që është hequr nga puna, pagesë e cila është kryer sipas Urdhër shpenzimit nr.8, datë 06.03.2018, urdhrit nr.27 dhe nr.28, datë 23.01.2018 të z.E. A ish-Kryeinspektorit të ISHMPUT Tiranë, aktit administrativ nr.266, datë 14.08.2016.

- vlera 48 mijë lekë (gjoba) të likuiduara për vonesa në derdhjen e kontributeve sigurimeve shoqërore, sipas urdhër shpenzimeve nr. 77, 78, 79 dhe 80, datë 29.10.2019.

Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, me Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me pikën 62 të UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 22-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomadimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e për vlerën 271 mijë lekë, të nxjerrë përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës, si dhe ngarkimin e tyre me arkëtimin e vlerës.

-Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerës 48 mijë lekë, likuidim i gjobave të vendosura, për vonesa në derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga fondet e DR ISHMPUT Vlorë.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste nuk është kryer pagesa e tarifës vjetore të lejes mjedisore të tipit C (2 mijë lekë/leje mjedisore), në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, pika 5, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 14 mijë lekë* (*Më hollësisht trajtuar në pikat 6 dhe 7, faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt në buxhetin e shtetit në vlerën 14,000 lekë, për subjektet të cilat nuk kanë paguar tarifën vjetore, .

Gjithashtu, në rastet kur nga subjektet nuk respektohet afati ligjor për kryerjen e pagesës së tarifës vjetore të lejes mjedisore, të çdo lloji A dhe B, DRM Fier të marrë masat për revokimin e lejes mjedisore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, është konstatuar se, për dy aplikime për leje mjedisore të tipit C, nga i njëjti subjekt “O” shpk, por me vendndodhje të ndryshme (Vlorë dhe Sarandë) është dorëzuar vetëm një mandat pagesë, për tarifën e aplikimit në vlerën (10 mijë lekë), dhe nga DRM Vlorë është pranuar dhe miratuar aplikimi për lejen mjedisore të tipit C, duke krijuar të ardhura të munguara *me efekt negativ në buxhetin e shtetit në vlerën 10 mijë lekë*, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3, shkronja c të VKM



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” (Më hollësisht trajtuar në pikat 6 dhe 7, faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt ngeativ në buxhetin e shtetit në vlerën 10 mijë lekë nga subjekti “Olsi” shpk, si dhe nëse është e nevojshme të bëjë revokimin e lejes mjedisore.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË MOS ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE NË MJEDIS DHE PËR MENXHIMIN ME EFEKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET.

Gjetje nga auditimi me efekte negative financiare të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 90,123 mijë lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Vlorë dhe Himarë, sipas listës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për subjektet aktive në treg, vendosur në dispozicion nga DRM Vlorë, gjatë vitit 2017-2018, janë hapur për herë të parë dhe janë aktive deri më 31.12.2018, gjithsej 222 subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me leje mjedisore, kryesisht të tipit B dhe C, nga të cilat:

- 150 subjekte nuk janë pajisur me leje të tipit C, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 1,500 mijë lekë ($150 * 10$ mijë lekë/tarifa e pajisjes me lejen C);
- 72 subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me leje të tipit B, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 2,160 mijë lekë ($72 * 30$ mijë lekë/tarifa e pajisjes me lejen C) dhe që kanë ndikim të lartë në mjedis, për të cilat nga DRM Vlorë në bashkëpunim me DRISHMPUT Vlorë nuk është marrë asnjë masë, për pajisjen e tyre me leje mjedisore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën c, pika 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar pikat 6 dhe 7, faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme për eliminimin e praktikave të tilla në të ardhmen dhe me ndikim negativ financiar në buxhetin e shtetit, duke garantuar që asnjë subjekt të mos ushtrojë aktivitet pa lejen mjedisore përkatëse. Gjithashtu, nga DRM Fier të marren masa për vlerësimin e situatës së krijuar dhe nxjerrjen e përgjegjësi rast pas rasti ndaj personave që kanë lejuar këtë situatë, si dhe ngarkimin e tyre me përgjegjësi ligjore.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë, rezulton se nga 362 subjekte të inspektuara përgjatë vitit 2019, kanë rezultuar pa leje mjedisore 192 subjekte, për të cilat nuk është marrë masë administrative gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 57,600 mijë lekë (192 subjekte $* 300,000$ lekë që është vlera minimale e gjobës që duhej të vendosej), duke vepruar në kundërshtim me nenin 1, 3, 5, 52 dhe 69 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masat e nevojshme, për rishqyrtimin e inspektimeve të kryera në 192 subjektet e mësipërme, të nxirren përgjegjësitë dhe personat përgjegjës deri në ngarkimin e tyre me përgjegjësi ligjore, për mos aplikimin e masave parandaluese dhe penalizuese në vlerën 57,600 mijë lekë, ndaj subjekteve të konstatuara pa leje mjedisore.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

3. Gjetje nga auditimi: DRISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, duke mos vendosur asnjë penalitet ndaj subjekteve të cilat kanë hedhur mbetjet e tyre në 337 ambiente dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me efekt negativ financiar në vlerën *10,110 mijë lekë*, vlera minimale në rast se do të ishin vendosur gjoba ndaj këtyre subjekteve, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të bëra në nenet 1, 3, 5, 52, 69 të Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar; në nenin 21, pika 19 dhe nenin 30 e 37 të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet e shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe nenin 4 pika 33 të nenit 73, pikën 1 të nenit 97 të Ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të analizojë situatën, të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, duke vendosur penalitete, ndaj subjekteve që hedhin mbetje në vende të pa përcaktuara nga bashkitë e Qarkut Vlorë, Qarkut Fier dhe Qarkut Gjirokastrë, me qëllim eliminimin e praktikave që sjellin efekte negative financiare në buxhetin e shtetit.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ISHMPUT Vlorë nuk ka përmbushur detyrat funksionale të saj, pasi nga 319 inspektime të kryera për periudhën 2018-2019, janë marrë gjithsej 66 vendime dënime administrative “Gjobë” me vlerë 19,056 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 633 mijë lekë (12 gjoba të paguara), ose 3.3% e gjobave të vendosura, duke krijuar efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit, në vlerën *18,423 mijë lekë*, si pasojë e mosarkëtimit të tyre. Konkretisht:

- Për vitin 2018 janë marrë 35 vendime administrative, në vlerën 9,851 mijë lekë, nga këto, 19 mjedisi dhe 16 policia pyjore, nga të cilat janë arkëtuar 7 subjekte, për shumën 603 mijë lekë, ose 6 % ndaj totalit vlerës gjobave.

- Për vitin 2019 janë marrë 31 vendime administrative, për shumën 9,205 mijë lekë, nga këto 12 mjedisi dhe 19 sektori i policisë pyjore, nga të cilat janë arkëtuar nga 5 subjekte në vlerën 30 mijë lekë, ose 0,3% e totalit të gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, në pikën 1 të nenit 40/1, të ligjit nr.9385, datë 23.04.2009 “Për pyjet e shërbimin pyjor” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier të marrë masa që të hartohet një program pune, me afate të përcaktuara e persona përgjegjës për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën *18,423 mijë lekë* nga vendosja e masave administrative (gjobë), si dhe të marrë masa për kontabilizimin e tyre si të ardhura dytësore, në bilancin financiar, tek pasqyra e të ardhurave, formati nr. 2, llogaria 7115 “*Gjoba, kamatëvonesa etj.*” kap. III “*Të ardhura jo tatimore*”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në 11 raste, nga shqyrtimi i regjistrit të transferimit/shkarkimit të ndotësve, si dhe librit të protokollit, konstatohet se nuk janë sjellë raportet e vetë-monitorimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara në kushtet e lejes mjedisore të tipit C, për të cilat DRM Vlorë ka njoftuar DRISHMPUT Vlorë, me qëllim inspektimin dhe vendosjen e penalitetit për mos përmbushje të kushteve të lejes mjedisore, dhe nga kjo e fundit, nuk është marrë asnjë masë e tillë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1/b.i dhe pikën 3 të nenit 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, duke krijuar të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ISH DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU VLORË DHE ISH DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT, VLORË, AKTUALISHT DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT FIER.

ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 330 mijë lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqet 45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier në bashkëpunim me AKM, në zbatim të pikës 1/b.i dhe pikës 3 të nenit 29, të Ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masat e nevojshme për rishqyrtimin e inspektimeve të kryera, vlerësimin e rëndësisë së shkeljes, për 11 subjektet private: “E. A”, “O” Shpk Vlorë dhe Sarandë”, “N. A.T”, “A. Ç”, “A. H”, “A. S”, “Y. B”, “M. shpk”, “C Shpk”, “J. Ç”, monitorimin e tyre në përmbushje të kushteve të lejes mjedisore, dhe në rast të shkeljes së vazhdueshme nga ana e tyre t’i propozojë Ministrisë të MTM-së revokimin e lejes mjedisore.

Menjëherë

KONTROLI I LARTË I SHTETIT